



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË UNIVERSITETIN
E VLORËS “ISMAIL QEMALI”

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI



MBI AUDITIMIN E “SISTEMEVE TË **TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT” NË** **UNIVERSITETIN E VLORËS “ISMAIL QEMALI”**

Tiranë, Dhjetor 2022

PËRMBAJTJA

Nr.	EMËRTIMI	Faqe
I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4
	1 Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	4
	2 Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	5
	3 Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i Auditimit	7
II.	HYRJA	7
	1 Objekti i auditimit	7
	2 Qëllimi i auditimit	7
	3 Identifikimi i çështjes	8
	4 Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	8
	5 Përgjegjësitë e audituesve	8
	6 Kriteret e vlerësimit	9
	7 Standardet e auditimit	9
	8 Metodatat e auditimit	10
	9 Dokumentimi i auditimit	10
III.	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	10
	1 Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	10
	2 Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit	11
	2.1 Auditimi i funksionimit të Qeverisjes TIK	11-14
	<i>Verifikimi i strategjisë, politikave dhe procedurave në TIK dhe vlerësimi i burimeve njerëzore në TIK</i>	
	<i>Identifikimi dhe menaxhimi i risqeve në TIK dhe në ofrimin e shërbimit</i>	
	2.2 Auditimi i zhvillimit dhe blerjes në teknologjinë e informacionit	14-28
	<i>a Identifikimi, hartimi i nevojave dhe kriterëve të vendosura për mallra dhe shërbime.</i>	
	<i>b Procedurat e Investimeve në fushën TIK dhe Marrëveshjet e Nivelit të shërbimit.</i>	
	2.3 Auditimi i Sigurisë së Informacionit	28-36
	<i>a Verifikimi i shkallës së sigurisë fizike dhe aksesit në rrjet</i>	
	<i>b Siguria e të dhënave dhe vazhdimësia në ofrimin e shërbimit</i>	
	2.4 Auditimi i Sistemeve	37-43
	<i>a Verifikimi i kontrolleve të aplikacioneve për të dhënat Input/output.</i>	
	<i>b Kontrolli i shkallës së sigurisë së aplikacioneve, të drejtat e përdoruesve dhe menaxhimi i tyre</i>	
IV.	GJETJET DHE REKOMANDIMET	44

LISTA E SHKURTIMEVE

Shkurtimi Emërtimi i Plotë

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
RSH	Republika e Shqipërisë
APP	Agjencia e Prokurimit Publik
SPE	Sistemi i Prokurimit Publik
RASH	Rrjeti Akademik Shqiptar
AKSHI	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit
AKCESK	Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike
BCP	Business Continuity Plan
ALCIRT	Agjencia Kombëtare për Sigurinë Kibernetike
BCC	Business Continuity Center
MNSH	Marrëveshjeve Nivel Shërbimi
AK	Autoriteti Kontraktues
OE	Operator Ekonomik
TI(IT)	Teknologjia e Informacionit
TIK	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimi
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
KM	Këshilli i Ministrave
PBB	Produkti i Brendshëm Bruto
COBIT	Objektivat e Kontrollit për Informacionin dhe Teknologjinë përkatëse
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
BE	Bashkimi Evropian
SSL	Secure Sockets Layer
VPN	Virtual Private Network
LAN	Local area network
IP	Internet Protocol

1.PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) mbështetur në nenet 3 dhe 14 të ligjit 154 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, datë 27.11.2014, zhvilloi një Auditim të Teknologjisë së Informacionit në Universitetin e Vlorës Ismail Qemali, nga data 30.05.2022 deri më datë 30.09.2022.

Grupi i auditimit mblodhi informacione, zhvilloi pyetësorë e intervista për caktimin e zonave me risk të lartë dhe mbështetur në to hartoi matricat e auditimit.

Kërkesat për informacion për fushat përkatëse u hartuan në përputhje me manualin e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit.

I.1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Projekti i auditimit, për auditimin e Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit, në Universitetin e Vlorës Ismail Qemali, është pjesë e Planit Vjetor 2022 të auditimit të KLSH-së, miratuar nga Kryetari i KLSH. Projektimi i këtij auditimi, është bërë bazuar në një analizë risku, si gjatë hartimit të planit vjetor, po ashtu edhe gjatë hartimit të Programit të Projektit të Auditimit, ku KLSH, ka vlerësuar si të rëndësishëm auditimin e sistemeve të teknologjisë që Universiteti i Vlorës Ismail Qemali disponon, për të garantuar disponibilitet dhe integritet të të dhënave. Nga ana e subjektit janë përcjellë në KLSH dy kopje të Projektraportit të auditimit të shoqëruar me deklaratën e nënshkruar nga titullari i insitucionit Nga grupi i auditimit janë shqyrtuar observacionet e dërguara mbi akt konstatimet dhe projektraportin e auditimit. Në konsideratë janë marrë ato kundërshti për të cilat janë paraqitur dokumentacion shtesë, ndërsa për rastet e tjera të cilat nuk gjejnë argumentim, mangësitë gjejnë pasqyrim në këtë Raport Përfundimtar Auditimi. Mbështetur në punën audituese në terren, evidencat e marra kanë qenë të mjaftueshme dhe të besueshme për punën audituese, mbështetur në Projektraportin e auditimit, komentet e subjektit të audituar, qëndrimin e grupit të auditimit ndaj komenteve të subjektit, rezultatet kryesore të punës audituese përfshihen në këtë përmbledhje ekzekutive të Raportit Përfundimtar. Auditimi i sistemeve të Informacionit është e rëndësishme për institucionet, kjo si pasojë e rritjes së kompleksitetit të kontrollit të aksesit dhe ruajtjes së konfidencialitetit, integritetit dhe gatishmërisë së të dhënave nga marrëdhëniet e rrjeteve publike me ato private dhe nga bashkë përdorimi i burimeve të informacionit. Siguria e Informacionit përcaktohet si mundësia e një sistemi për të mbrojtur informacionin dhe burimet e sistemeve në përputhje me termat e konfidencialitetit, integritetit dhe gatishmërisë. Sistemet e informacionit janë bashkime komplekse të teknologjisë, proceseve dhe njerëzve që funksionojnë së bashku për të rregulluar përpunimin, ruajtjen, dhe transferimin e informacionit për të mbështetur misionin e institucionit dhe funksionet e tij. Lidhur nga sa më sipër, çdo institucion shtetëror që ofron shërbime ndaj qytetarëve e ka si detyrim ndërtimin e programit të sigurisë së informacionit me elementët kyç të cilët janë: “Mjedisi i sigurisë së informacionit, Vlerësimi i riskut, Politikat e sigurisë, Organizimi i sigurisë së TIK, Menaxhimi i aseteve, Siguria e burimeve njerëzore, Siguria fizike dhe mjedisore, Kontrolli i aksesit, Menaxhimi i incidenteve të sigurisë së TIK, Menaxhimi i vazhdueshmërisë së biznesit, Përputhshmëria

I.2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve:

Gjetje nr.	Përmbledhje e Gjetjes	Referenca me Raportin Përfundimtar	Rëndësia	Rekomandimi
1.	Nga auditimi u konstatua se, Universiteti i Vlorës nuk disponon regjistër risku të përgjithshëm institucional, ku të përfshihen edhe risqet mbi IT dhe të mbulohen të gjithë aktivitetet duke përfshirë këtu risqet mbi sistemet, proceset e menaxhimit të ndryshimit, etj. Nuk ka identifikuar dhe vlerësuar ngjarjet e mundshme që mund të kenë efekt negativ përsa i përket arritjes së objektivave institucionale	faqe 11-14	E Lartë	Universiteti i Vlorës “Ismail Qemali” të marr masa për identifikimin dhe analizimin e risqeve për Teknologjinë e Informacionit me qëllim analizimin dhe vlerësimin e risqeve, për të mos riskuar përmbushjen e objektivave të institucionit në përputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar. Gjithashtu të marrin masa për hartimin dhe dokumentimin e një plani veprimi për minimizimin / parandalimin e risqeve të identifikuara, si dhe të bëhet monitorimi periodik i zbatimit të këtyre masave.
2	Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se investimi në vlerën 24,499,000 lekë pa TVSH me urdhër nr.957/1 datë 22.06.2020 të administratorit për procedurën e prokurimit: ‘Krijimi i Datacenter dhe Ndërtimi i Sistemit të Integruar për menaxhimin e bibliotekës dixhitale ’është një investim pa efektivitet. Qëllimi për realizimin e këtij investimi është i njëjtë me investimin e planifikuar nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë , si një nga premtimet e “Paktit për Universitetin” që do të adresonte problematikën e kostove të blerjes së librave dhe do të rriste aksesin e studentëve në botime të ndryshme Universitare. Ndërtimi i një biblioteke online me standarde	faqe 14-28	E Lartë	Administratori i Universitetit të marrë masa duke analizuar mangësitë e konstatuara dhe në të ardhmen të miratojë realizimin e procedurave të prokurimit të cilat sjellin përmirësim dhe ndihmojnë në përmbushjen e misionit të Universitetit, për stafin akademik dhe studentët.

	evropiane ishte një ndër kërkesat e studentëve. Përfitues i këtij investimi është dhe universiteti “Ismail Qemali			
3	Nga auditimi i dokumentacionit të procedurës të prokurimit Krijimi i Datacenter dhe Ndërtimi i Sistemit të Integruar për menaxhimin e bibliotekës dixhitale rezultoi se disa prej kriterëve të veçanta për kualifikim janë të mbivendosura dhe të panevojshme për zbatimin e kontratës	faqe 14-28	E Lartë	Sektori i prokurimeve, grupet e hartimit të kriterëve për kualifikim, të marrin masa që në të ardhmen, në hartimin e Dokumenteve Standarde të procedurave të prokurimit, të shmangin vendosjen e kriterëve diskriminues për të krijuar kushtet e një konkurrence të lirë për pjesëmarrjen në tender të sa më shumë operatorëve ekonomik
4	Nga auditimi u konstatua se UV, nuk ka ngritur Active Directory për menaxhimin e userave, pajisjeve, aplikacioneve dhe marrjen e shërbimeve me anë të një autentifikimi të vetëm “ <i>single sign in</i> ” për një identifikim të qendërzuar të sigurt të kontrollit dhe menaxhimin e shërbimeve në përputhje me standardet më të mira	faqe 28-36	E Lartë	Universiteti i Vlorës të marrë masa për planifikimin dhe ngritjen e një Active Directory me qëllim standardizimin e infrastrukturës IT, rritjen e sigurisë së rrjetit si dhe garantimin e një identifikimi të qendërzuar dhe të sigurt
5	Për periudhën e audituar, u konstatua se Universiteti i Vlorës nuk ka politika të ruajtjes së dokumenteve dhe nuk ka të dokumentuar një plan masash për identifikimin, trajtimin e gabimeve dhe incidenteve që mund të ndodhin në infrastrukturën IT, dhe në mungesë të procedurave të shkruara, risqet menaxhohen mbi bazë ngjarjesh. Suporti, mbështetje teknike dhe logjike për operacionet IT që ndihmojnë mbarëvajtjen e strukturave të institucionit, kryhen nëpërmjet shkëmbimeve verbale dhe nëpërmjet e-mail-eve	faqe 28-36	E Lartë	Strukturat Drejtuese në Universitetin e Vlorës në bashkëpunim me sektorin TIK të marrin masa për identifikimin, dokumentimin dhe monitorimin e incidenteve si dhe menaxhimin e ndryshimeve dhe dokumentimin e tyre.

I.3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i Auditimit:

Kemi audituar Sistemet e Teknologjisë së Informacionit për periudhën ushtrimore 01.01.2020-31.12.2021 në të cilat përfshihet Qeverisja IT, procedurat e prokurimeve TIK Siguria e Informacionit, Sistemet e Informacionit. Grupi i auditimit është mbështetur në Standardet ndërkombëtare të Auditimit përkatësisht në ISSAI 100, ISSAI 5300, ISSAI 5310 si dhe nenet 3 dhe 14 të ligjit 154 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH” datë 27.11.2014

- Sipas opinionit tonë, pas shqyrtimit të evidencave të marra Universiteti Ismail Qemali ka zhvilluar sisteme të Teknologjisë së Informacionit pa hartuar bazën e nevojshme rregullatore për funksionimin e tyre dhe të pa mbështetura me burimet e nevojshme njerëzore. Investimet në sistemet e informacionit nuk kanë zgjidhur përfundimisht problemet e sigurisë së informacionit, sigurimin e Vazhdueshmërisë së Biznesit Në gjykimin tonë, identifikimi dhe administrimi i elementëve kritikë në ofrimin shërbimeve dhe garantimin e sigurisë së të dhënave si dhe vazhdimësisë në ofrimin e shërbimit nëpërmjet teknologjisë së informacionit është i pa pamjaftueshëm.. Ne kemi audituar zbatueshmërinë e akteve ligjore dhe nën ligjore (kriteret e vlerësimit), për, procedurat e prokurimit publik për investimet në fushën e Teknologjisë së Informacionit të zhvilluara gjatë periudhës objekt auditimi nga 01.01.2020 deri më 31.12.2021, subjekti i audituar, Universiteti i Vlorës “Ismail Qemali”, ka marrësi në veprime në përputhje me kriteret e përcaktuara në bazën ligjore dhe rregullatore.

HYRJA

Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH”, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 468/3, datë 27.05.2022 të miratuar nga Kryetari i KLSH, me afat auditimi 27.05.2022 deri në 30.09.2022, në Universitetin e Vlorës, “Ismail Qemali” ku periudha e audituar është 01.01.2020 deri në 31.12.2021, u krye auditimi me objekt “*Auditimi i Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit*”, nga audituesit:

1. R.A, Përgjegjës Grupi
2. B.H, Anëtar
3. E.C, Anëtare
4. M.P, Anëtare
5. A.K, Anëtare
6. K.S, Anëtare

II.1. Objekti i auditimit

Objekti i Auditimit TIK është përcaktimi nëse objektivat e subjektit arrihen në mënyrën e duhur duke përdorur burimet IT, duke përfshirë pajtueshmërinë me kërkesat ligjore dhe rregullative, konfidencialitetin, integritetin si dhe disponueshmërinë e sistemeve të informacionit dhe të dhënave që gjenden në të.

II.2. Qëllimi i auditimit

Qëllimi i Auditimit TIK ushtruar në Universitetin e Vlorës “Ismail Qemali”, është dhënia e opinionit apo vlerësimit nëse ekzistojnë kontrollet dhe mekanizmat e duhur me qëllim krijimin, mirëmbajtjen e burimeve IT dhe funksioneve për të cilat këto burime shërbejnë. Për të arritur

në dhënien e një opinioni, janë mbledhur informacione, të dhëna dhe prova, për të përcaktuar nëse nëpërmjet teknologjisë së informacionit mbrohen asetet, ruhet integriteti i të dhënave, si dhe synimet e subjektit që auditohet arrihen në mënyrë efektive duke përdorur burimet në mënyrë eficiente. Kërkesat për informacion sipas drejtimeve të programit të auditimit, u hartuan në përputhje me Manualin e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit.

II.3 Identifikimi i çështjeve:

Drejtmet e këtij auditimi janë bazuar në programin e auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit të protokolluar me nr.468/3, datë 27.05.2022:

1.Auditimi i funksionimit të Qeverisjes TIK

- a. Verifikimi i Strategjisë, politikave dhe burimeve njerëzore në TIK.*
- b. Identifikimi dhe menaxhimi i risqeve në TIK dhe në ofrimin e shërbimit.*

2.Auditimi i zhvillimit dhe i blerjes në Teknologjinë e Informacionit

- a. Identifikimi, hartimi i nevojave dhe kriterëve të vendosura për mallra dhe shërbime.*
- b. Procedurat e Investimeve në fushën TIK dhe Marrëveshjet e Nivelit të shërbimit.*

3.Auditimi i Sigurisë së Informacionit

- a. Siguria e të dhënave dhe vazhdimësia e ofrimit të shërbimit.*
- b. Verifikimi i shkallës së sigurisë fizike dhe aksesit në rrjet.*

4.Auditimi i Sistemeve

- a. Verifikimi i kontrolleve të aplikacioneve për të dhënat Input/output.*
- b. Kontrolli i shkallës së sigurisë së aplikacioneve, të drejtat e përdoruesve dhe menaxhimi i tyre.*

II.4 Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar

Universitetet synojmë të formojmë dhe të përgatisim, studentë premtues, profesionistë e cilësorë në përshtatje me trendin e tregut të punës, shkencetarë në shërbim të zhvillimeve dinamike jo vetëm në kontekstin kombëtar por edhe në atë europian e më gjerë, duke kaluar çdo barrierë të lidhur me prejardhjen e tyre sociale, ekonomike apo kulturore. Misioni i Universiteteve është i orientuar në këto drejtime:

- Të kontribuojë në promovimin dhe përhapjen e njohurive shkencore nëpërmjet ofrimit të një game të gjerë të disiplinave të mësimdhënies dhe kërkimit.
- Të sigurojë mjetet e nevojshme për një karrierë të suksesshme për studentët, për stafin akademik, ndihmës akademik dhe administrativ.
- Të sigurojë një rol udhëheqës në ekonominë lokale si edhe në zhvillimin kulturor të Shqipërisë dhe më gjerë.
- Të ndihmojë në përmbushjen e nevojave sociale, kulturore dhe zhvillimore të vendit

II.5 Përgjegjësitë e audituesve

K Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi Universitetin e Vlorës “Ismail Qemali”, mbi periudhën e veprimtarisë nga 01.01.2020 deri në 31.12.2021, duke i kushtuar vëmendje çështjeve që lidhen me zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë si dhe standardeve ndërkombëtare të teknologjisë dhe auditimit TIK.

Nga grupi i auditimit, me përgjegjësi të plotë, janë analizuar të gjitha çështjet që përmban Programi i Auditimit nr. 468/3, datë 27.05.2022 miratuar nga Kryetari i KLSH. Në realizimin e këtij Projekt Auditimi, grupi i auditimit është mbështetur në bazën ligjore mbi të cilën funksionon KLSH, standardet e auditimit, legjislacionin e fushës në të cilën operon Universiteti i Vlorës. Gjithashtu, gjatë veprimtarisë audituese, është siguruar një evidencë e përshtatshme,

e mjaftueshme dhe e besueshme auditimi, në të cilën jemi mbështetur në dhënien e konkluzioneve dhe rekomandimeve.

II.6 Kriteret e vlerësimit

Kriteret e vlerësimit janë bazuar në ligjet, rregulloret në fuqi, standardet ndërkombëtare COBIT dhe ISSAI 5300 për auditimin e Teknologjisë së Informacionit si dhe Manualin e Teknologjisë së Informacionit. Opinioni i auditimit mbështetet në praktikën më të mira, Standardet Kombëtare dhe Ndërkombëtare të Auditimit. Në këtë raport përfundimtar krahas gjetjeve që janë konstatuar, grupi i auditimit ka rekomanduar disa masa organizative, për përmirësimin e situatës.

Aktet ligjore dhe rregullative mbi të cilat është mbështetur vlerësimi janë si më poshtë:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (nenet 162-165)
- Ligji nr. 154/2014 “Mbi Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Ligji Nr. 80/2015 për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë
- Ligji Nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar
- Ligji Nr. 162 Datë 23.12.2020 Për Prokurimin Publik.
- Ligji Nr 10296, datë 08.07.2010 “ Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar dhe aktet ligjore të zbatimit të tij.
- Ligji Nr 114/2015 “Për auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”
- Legjislacioni mbi krimin Kibernetikë.
- Ligji Nr. 10325, datë 23.09.2010, Për Bazat e të Dhënave Shtetërore”.
- Ligji Nr 9887, datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012 “ Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”
- Vendim Nr. 285, Datë 19.5.2021 Për Miratimin E Rregullave Të Prokurimit Publik (Ndryshuar Me Vendimin Nr. 710, Datë 24.11.2021)
- Vendimi nr. 914, datë 29.12.2014, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,
- VKM nr. 945, datë 02.11.2012 “Për miratimin e rregullores administrimi i sistemit të bazave të të Dhënave Shtetërore
- VKM nr. 710, datë 21.08.2013 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit”, i ndryshuar;
- Standardet TIK;
- Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, i ndryshuar;
- Udhëzimi nr. 1159, datë 17.03.2014 “Për hartimin e Marrëveshjes të Nivelit të Shërbimit”, i ndryshuar;
- Rregullore e brendshme “Mbi organizimin dhe funksionimin administrativ të KLSH-së”, miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 85, datë 30.06.2015 e ndryshuar;
- Rregullore e brendshme “Mbi Procedurat e auditimit në KLSH”, miratuar me vendimin nr. 107, datë 08.08.2017 të Kryetarit të KLSH-së e ndryshuar;

II.7 Standardet e auditimit

Auditimi është kryer, në përputhje me Kodin Etik, Standardet, dhe teknikat e auditimit të teknologjisë së informacionit, duke përfshirë pyetësorë, intervista, testim dhe procedura, të

cilat u gjykuan se ishin të nevojshme, për të dhënë një vlerësim sa më objektiv, profesional e të pavarur, të saktë, të plotë e të qartë, duke u fokusuar veçanërisht në standardet e fushës së auditimit të TIK, si: COBIT 4.1, Manuali i Auditimit IT, ISSAI 5310, etj

II.8 Metodat e auditimit

Metodat mbi auditimin e sistemeve të Teknologjisë së Informacionit që grupi i auditimit ka ndjekur në Universitetin e Vlorës “Ismail Qemali, janë si më poshtë:

- Intervista zhvilluar në subjekt me personat përgjegjës;
- Verifikime të sistemit si auditues;
- Shqyrtimi i dokumentacionit rregullativ të institucionit;
- Analizimi i të dhënave të eksportuara nga sistemi;

II.9 Dokumentimi i auditimit

Dokumentimi i auditimit është bazuar në rregulloren e brendshme të KLSH si dhe në manualin aktiv të auditimit të Teknologjisë së Informacionit në të cilin janë përfshirë:

- Planifikimi, qëllimi dhe objektivat e auditimit;
- Programi i auditimit;
- Evidencat e grumbulluara në lidhje me të dhënat e sistemit, raporte të ndryshme me të dhëna nxjerrë nga sistemi;
- Letrat e punës mbajtur nga audituesit sipas detyrave të përcaktuara gjatë fazës së auditimit në terren.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

III.1 Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim

Universiteti i Vlorës u themelua më 10 tetor 1994, me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.105, datë 28.02.1994. Për hapjen e tij u bë një punë disa mujore për përgatitjen e planeve, programeve dhe përzgjedhjen e stafit akademik. Në vitin 2017 UV u akreditua për herë të parë nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) në bashkëpunim me ekspertë anglez. *Misioni i Universitetit “Ismail Qemali”* është të formojë dhe të përgatisi, studentë premtues, profesionistë e cilësorë në përshtatje me trendin e tregut të punës, shkencëtarë në shërbim të zhvillimeve dinamike jo vetëm në kontekstin kombëtar por edhe në atë evropian e më gjerë, duke kaluar çdo barrierë të lidhur me prejardhjen e tyre sociale, ekonomike apo kulturore. Roli dhe misioni i UV-së bazohet në katër përbërësit kryesor që përfshijnë:

- Mësimdhënie bashkëkohore sipas të gjitha standardeve ndërkombëtare, Deklaratës së Bolonjës dhe Kornizës Shqiptare të Kualifikimit.
- Punë kërkimore bazë dhe të aplikuar.
- Punë akademike të cilësisë së lartë në përputhje me standardet evropiane ESCO të Komunitetit Evropian
- Shërbime të efektshme dhe ndikuese në publik dhe në komunitet, programe gjithëpërfshirëse aktivitetesh për zhvillimin e studentëve dhe krijimin e shkencëtarëve të ardhshëm.
- Të kontribuojë në promovimin dhe përhapjen e njohurive shkencore nëpërmjet ofrimit të një game të gjerë të disiplinave të mësimdhënies dhe kërkimit.
- Të sigurojë mjetet e nevojshme për një karrierë të suksesshme për studentët, për stafin akademik, ndihmës akademik dhe administrativ.
- Të sigurojë një rol udhëheqës në ekonominë lokale si edhe në zhvillimin kulturor të qytetit të Vlorës dhe më gjerë.

- Të ndihmojë në përmbushjen e nevojave sociale, kulturore dhe zhvillimore të vendit. Misini i Universitetit bazohet edhe në Ligjin Nr 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë". Veçanërisht, është me vlerë për tu theksuar komponenti arsimor i Universitetit dhe roli i tij në formimin e qytetarit modern për të siguruar arsimimin/edukimin si një e mirë dhe e drejtë shoqërore publike. Vizioni kryesor i UV-së është të ketë një ndikim transformues në shoqëri përmes inovacionit të vazhdueshëm në arsim, hulumtim, kreativitet të lartë dhe pjesëmarrjes aktive në zhvillimin social dhe ekonomik të vendit.

III.2. PËRSHKRIM I REZULTATEVE SIPAS DREJTIMEVE TË AUDITIMIT:

III.2.1. Auditimi i funksionimit të Qeverisjes TIK

Verifikimi i procedurave dhe burimeve njerëzore në TIK

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë funksionin në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*".

Në mbështetje të nenit 33 të Ligjit Nr. 80/2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*", universiteti ka nxjerr Statutin dhe rregulloren e institucionit të arsimit të lartë. Statuti i UV-së është i miratuar me Urdhër të Ministrisë së Arsimit nr. 197, datë 01.04.2019. Pas miratimit të Statutit, Senati Akademik miratoi Rregulloren e brendshme me vendim nr. 20, datë 11.04.2022 nga e cila rrjedhin rregulloret e brendshme të fakulteteve për rregullimin dhe mirë funksionimin e tyre.

UV e rregullon veprimtarinë e saj akademike dhe administrative në zbatim edhe të akteve të tjera nënligjore: Vendime të organeve të kolegjinale Senatit Akademik, Bordit të Administrimit si dhe vendime, urdhra dhe udhëzime të autoriteteve drejtuese.

➤ Verifikimi i strategjisë, politikave dhe burimeve njerëzore në TIK


Universiteti i Vlorës në mbështetje të Planit Strategjik 2018-2024 funksionin si Universitet SMART, si skenar zhvillimi fokusohet në shfrytëzimin me efektivitet të teknologjisë së komunikimit dhe informacionit në sistemin e menaxhimit dhe organizimit të universitetit duke përsosur sistemin SIUV, procesin e mësimdhënies dhe kontrollit përmes aplikimit të metodave inovative të mësimdhënies (e-learning, eclassroom), procesit të pranimit, regjistrimit dhe ofrimit të shërbimeve për studentët përmes përmirësimit të sistemit UMS, zgjerimit të target grupit të studentëve përmes ofrimit të kurseve online të studimit, krijimit të një infrastrukture moderne me shërbim interneti broadband cilësor, shfrytëzimit në mënyrë efektive të burimeve të energjisë, promovimit të një sistemi të qëndrueshëm të trajtimit të mbetjeve, krijimit të një mjedisi infrastrukturor miqësor me mjedisin.

Politikat dhe burimet njerëzore në TIK

Në mbështetje të Ligjit nr. 80/2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë*", struktura e përgjithshme në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë është e miratuar me vendim të Senatit Akademik nr.12, datë 27.02.2019 "*Për miratimin e disa ndryshimeve në strukturën organizative të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë*" dhe me vendim të Bordit të Administrimit nr.17, datë 03.04.2019 "*Për miratimin e numrit të personelit në të gjitha nivelet në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë*", në këtë Vendim Sektori i Shërbimeve Teknologjike dhe Zhvillimit ka ndryshuar emërtim duke u ri-emërtuar në Sektori i IT-së si dhe ka kaluar në varësi të Drejtorisë së Komunikimit dhe Burimeve Njerëzore (DKBNJ).

Sektori i IT-së në UV është pjesë e Njesisë ndihmës akademik me karakter administrativ në nivel institucional dhe është në varësi të Drejtorisë së Komunikimit dhe Burimeve Njerëzore. Ky sektor është i përbërë nga përgjegjësi i sektorit dhe nga 3 specialist të IT-së në fakultete,

Figura nr.1: Struktura e Sektorit IT



Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit

UT ka në përbërjen e tij katër fakultete:

- Fakulteti i Ekonomisë;
- Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Natyrore;
- Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë;
- Fakulteti i Shëndetit Publik.

Fusha specifike e secilës njësi kryesore përcaktohet në rregulloren e universitetit.

Nga auditimi u konstatua se, Rektorati në çdo Fakultet ka atashuar nga një specialist IT i cili është pjesë e Sektorit IT të Rektoratit të UV. Referuar strukturës së miratuar rezulton se për çdo fakultet nuk ka një pozicion faktik specialist IT specifik, të përcaktuar me një urdhër të brendshëm ose akt rregullativ për secilin nga 5 fakultete që janë në varësi të Rektoratit të UV-së.

➤ **Trajnimet**

Trajnimi është një nga shtyllat e rëndësishme për menaxhimin e kapaciteteve. Personeli që ka akses në asetet dhe sistemet e teknologjisë së informacionit të Universitetit të Vlorës të jetë i vetëdijshëm për rregullat dhe standardet e sigurisë dhe të jenë të aftë t'i zbatojnë dhe ndjekin ato gjatë punës së tyre.

- Është e nevojshme që procesi të mbështetet në një identifikim dhe analizë të nevojave për trajnim të stafit, me qëllim që të sigurohet parashikimi, programimi dhe implementimi i suksesshëm i veprimtarive trajnuese.

Për periudhën objekt auditimi u konstatua se Universiteti i Vlorës, nuk ka plan trajnimi vjetor për vitin 2020 dhe 2021 për burimet njerëzore si dhe nuk ka zhvilluar trajnime mbi sistemet, sigurinë dhe teknologjinë e informacionit.

Trajnimin e stafit akademik dhe administrativ për të rritur aftësitë e tyre në menaxhimin e sistemeve informatike të UV e kryen përgjegjësi i sektorit të Sektorit. Gjithashtu, specialistët e IT të këtij sektori atashuar pranë fakulteteve respektive janë përgjegjës për mbikëqyrjen dhe trajnimin e personelit akademik.

Nga auditimi u konstatua se, për periudhën objekt auditimi nuk janë zhvilluar trajnime për sektorin IT, personelin akademik mbi sistemet, sigurinë dhe teknologjinë e informacionit në kundërshtim me përshkrimin e punës miratuar me shkresën nr. Prot., 205/1 datë 14.02.2018.

➤ **Identifikimi dhe menaxhimi i risqeve në TIK**

Nga administrimi i dokumentacionit sesi Universiteti i Vlorës identifikon dhe menaxhon risqet institucionale dhe risqet në teknologjinë e informacionit, u konstatua se UV nuk disponon regjistër risku të përgjithshëm institucional, ku të përfshihen edhe risqet mbi IT dhe të mbulohen të gjithë aktivitetet duke përfshirë këtu risqet mbi sistemet, proceset e menaxhimit të ndryshimit, etj. UV nuk ka identifikuar dhe vlerësuar ngjarjet e mundshme që mund të kenë efekt negativ përse i përket arritjes së objektivave institucionale.

Nisur sa më sipër dhe mbështetur në nenin 11, pika 2, neni 12 pika 3/d dhe nenet 19-21 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 21, datë 25.10.2016 “Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve”, UMF nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”, Universiteti i Vlorës nuk disponon regjistër risku ku të përfshiheshin edhe risqet që lidhen me teknologjinë e informacionit.

- 1.Titulli i gjetjes:** Identifikimi dhe vlerësimi i problematikave mbi burimet njerëzore.
- Situata:** Nga auditimi u konstatua se, specialistët e Sektorit IT të cilët janë pjesë e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, janë të caktuar për të kryer detyra funksionale IT në secilin nga fakultetet e Vlorës, por për këtë shpërndarje të tyre nuk ka një Urdhër të brendshëm nga Rektorati. Gjithashtu, bazuar në strukturën e miratuar ka rezultuar se në asnjë fakultet nuk ka një pozicion specifik të përcaktuar për specialistët mbi kryerjen e detyrave të teknologjisë së informacionit.
- Kriteri: -**
- Ndikimi/Efekti:** Mos adresim të përcaktimit të detyrave, kompetencave dhe përgjegjësi.
- Shkaku:** Mos menaxhim i burimeve njerëzore
- Rëndësia:** E Lartë.
- 1.1.Rekomandimi:** Rektorati i Universitetit Vlorë duhet të marrë masa për nxjerrjen e një urdhri në të cilin të caktohen specialistët në fakultetet respektive si dhe të përcaktohen detyrat funksionale të secilit prej tyre.

- 2.Titulli i gjetjes:** Mungesa e parashikimit dhe zhvillimit të trajnimeve.
- Situata:** Nga auditimi u konstatua se, për periudhën objekt auditimi u konstatua se Universiteti i Vlorës, nuk ka plan trajnimi vjetor për vitet 2020 - 2021 për burimet njerëzore si dhe nuk ka zhvilluar trajnime për sektorin IT, personelin akademik mbi sistemet, sigurinë dhe teknologjinë e informacionit. Trajnimin e stafit akademik dhe administrativ për të rritur aftësitë e tyre në menaxhimin e sistemeve informatike të UV e kryen përgjegjësi i sektorit të Sektorit. Gjithashtu, specialistët e IT të këtij sektori atashuar pranë fakulteteve respektive janë përgjegjës për mbikëqyrjen dhe trajnimin e personelit akademik. Nga auditimi u konstatua se, për periudhën objekt auditimi nuk janë zhvilluar trajnime mbi sistemet, sigurinë dhe teknologjinë e informacionit në kundërshtim me përshkrimin e punës miratuar me shkresën nr. Prot., 205/1 datë 14.02.2018.
- Kriteri:** Përshkrimin e punës miratuar me shkresën nr. Prot., 205/1 datë 14.02.2018.
- Ndikimi/Efekti:** Risk në mos përmbushje të objektivave të përcaktuara.

Shkaku:	Mungesë planifikimi për zhvillimin e trajnime për burimet njerëzore.
Rëndësia:	E Lartë.
2.1.Rekomandimi:	Universiteti i Vlorës “Ismail Qemali” të marrë masa për identifikimin e nevojave për trajnimin e stafit i cili merret me administrimin e bazës së të dhënave dhe të çdo përdoruesi të sistemit, si dhe të hartojë e miratojë plane dhe politika për zhvillimin e trajnimeve në lidhje me sistemet, sigurinë dhe teknologjinë e informacionit
3.Titulli i gjetjes:	Identifikimi i risqeve në Teknologjinë e Informacionit.
Situata:	Nga auditimi u konstatua se, Universiteti i Vlorës nuk disponon regjistër rrishtu të përgjithshëm institucional, ku të përfshihen edhe rrishtet mbi IT dhe të mbulohen të gjithë aktivitetet duke përfshirë këtu rrishtet mbi sistemet, proceset e menaxhimit të ndryshimit, etj. Nuk ka identifikuar dhe vlerësuar ngjarjet e mundshme që mund të kenë efekt negativ përse i përket arritjes së objektivave institucionale.
Kriteri:	Neni 11, pika 2, neni 12 pika 3/d dhe nenet 19-21 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, i ndryshuar.
Ndikimi/Efekti:	Mos identifikim, mos adresim i problematikave që mund të shfaqen, shkelje e sigurisë.
Shkaku:	Mos zbatim i dispozitave ligjore.
Rëndësia:	E Lartë.
3.1.Rekomandimi:	Universiteti i Vlorës “Ismail Qemali” të marrë masa për identifikimin dhe analizimin e risqeve për Teknologjinë e Informacionit me qëllim analizimin dhe vlerësimin e risqeve, për të mos riskuar përmbushjen e objektivave të institucionit në përputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar. Gjithashtu të marrin masa për hartimin dhe dokumentimin e një plani veprimi për minimizimin / parandalimin e risqeve të identifikuar, si dhe të bëhet monitorimi periodik i zbatimit të këtyre masave.

2.2 Auditimi i zhvillimit dhe blerjes në teknologjinë e informacionit

Në zbatim të pikës 2 të Programit të Auditimit **nr.468/3** “*Auditimi i zhvillimit dhe i blerjes në Teknologjinë e Informacionit*” u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- 1- Lista e prokurimeve TIK të periudhës 01.01.2020 – 31.12.2021;
- 2- Dosjet e procedurave të përcaktuara për auditim, sipas analizës së rrishtut;
- 3- *Procedura Krijimi i Datacenter dhe Ndërtimi i Sistemit të Integruar për menaxhimin e bibliotekës dixhitale*
- 4- *Procedurat “Pagese Hostim Faqe” dhe Abonim Soft Per Detectimin e Plagjiatures*
- 5- DST e hartuar nga NJP për procedurat e përcaktuara për auditim;

6- Sistemi elektronik i APP, sipas kodit të marrë nga APP si auditues;

Procedura e prokurimit me objekt “Krijimi i Datacenter dhe Ndërtimi i Sistemit të Integruar për menaxhimin e Biblotekës “në vitin 2020.

Urdhër prokurimi, Nr,957/1 datë 22.06.2020	Hartuesit e specifikimeve Teknike 1.A.M (kryetar) 2.A.T 3.A.M 4. I.B 5.I.D	Komisioni i Vlerësimit të ofertave 1.E.I 2.J.M 3.A.H
Fondi Limit Loti : 24,999,000		
Procedura e prokurimit – Procedurë e hapur		
Datë e hapjes së tenderit 24.08.2020	Njësia e Prokurimit 1. O.GJ 2. E.N 3. F.LL	Komision. i marrjes në dorëzim 1.E.Z 2.M.M 3. A.H
Operatorët Ekonomike pjesëmarrës në tender: 1.”I dhe K” shpk 2. 3“shpk	Operatore te Kualifikuar: 1. .”I dhe K” shpk	Operatorë të s kualifikuar 1..”3 shpk
Ankimime në AK për vleresim- PO Ankesa nr.976, datë 29.06.2020 dërguar pranë AK nga OE B sh.p.k Ankesa nr.977, datë 29.06.2020 dërguar pranë AK nga OE P.S Ankesa nr.977, datë 29..06.2020 dërguar pranë AK nga OE B Ankesa nr 1152 datë 24.07.2022 dërguar pranë AK nga OE S	Diferenca nga fondi limit. 500,000	Vlera e kontratës 24,499,000
	Afati kontratës 120 dite nga data e nënshkrimit të kontratës	Operatori Fitues: .”I”dhe “K” shpk

Mbi hapat e ndjekur nga Universiteti Ismail Qemali për blerjen dhe implementimin e Datacenter dhe Sistemit të Integruar për menaxhimin e Biblotekës.

Universiteti Ismail Qemali ka në pronësi dhe në përdorim Datacenterein dhe Sistemin e Integruar për menaxhimin e Biblotekës. Datacenter është i vendosur në ambientet e Rektoratit dhe pajisjet për skanimin e librave janë vendosur në Biblotekën e Universitetit. Qëllimi i këtij investimi është krijimi i një biblioteke dixhitale e cila do të arkivojë dhe do të mundësojë leximin e librave online pas skanimit të literaturës ekzistuese në Biblotekën e Universitetit Ismail Qemali.

Anullimi i procedurës së parë:

Procedura me titull dhe objekt “ Krijimi i Biblotekës Dixhitale të Universitetit Ismail Qemali Vlorë” është anuluar me vendimin 109/2020 të Komisionit të Prokurimit Publik për arsye KPP ka dalë në vendimin se autoriteti kontraktor ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe rregullat e prokurimit publik dhe veprimet e tij kanë shërbyer si pengesë për operatorët ekonomik të interesuar për të marrë pjesë në atë procedure prokurimi. KPP i ka tërhequr vëmendje dhe për mos respektimin e afatit prej 10 ditësh që ligji i jep të drejtë operatorit ekonomik për të ushtruar të drejtën e ankimit pranë KPP. Në vendim KPP shprehet se Autoriteti Kontraktor nuk duhej të ishte proceduar në hapjen e ofertave në respekt të të drejtës që përcakton ligji për ankimin, pasi në këto kushte teknikisht nuk duhet të kryhej asnjë veprim për modifikimin e dokumenteve të tenderit si dhe të bëhet shtyrja e datës së zhvillimit të tij.

Procedura e prokurimit Krijimi i Datacenter dhe Ndërtimi i Sistemit te Integruar për menaxhimin e Biblotekës është rishpallur më datë 23.06.2020 në sistemin Elektronik të Prokurimeve me REF-62189-06-22-2020. .

Përgatitja e dokumenteve të tenderit

Më datë 1.06.2020 ka dalë urdhri nr. 844 nga Administratori për krijimin e komisionit për përcaktimin e specifikimeve teknike për krijimin e variantit optimal të bibliotekës dixhitale, të përbërë nga A.M Kryetar, A.T, A.M, I.B, I.D. Për llogaritjen e vlerës limit të kontratës janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në nenin 9 dhe 59 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Me shkresën nr. 957 datë 22.06.2020 njësia e prokurimit e përberë nga F.L.L, E.N dhe O.GJ ka argumentuar llogaritjen fondit limit duke bashkëlidhur tre ofertat e marra në treg. Bazuar në këto ofertat të marra grupi i punës llogariti fondin limit, bazuar në ofertën me çmime më të ulët " në vlerën **24,999,000 lekë**. Njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit mbështetur në specifikimet teknike dhe në fondin limit, në zbatim të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" dhe nenit 11 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", ka hartuar dokumentet e këtij tenderit të "Hapur". Po kështu, ka hartuar dhe vendosur në këto dokumente përveç kriterëve ligjorë të përgjithshme të pranimit kualifikimit edhe kriteret e veçanta kualifikuese. Përmes formularit të ankesës pranë autoritetit kontraktor janë paraqitur 4 ankesa nga operatorë të ndryshëm. Në këto ankesa operatorët ekonomik kanë paraqitur argumentimet për kundërshtimin e kriterëve të kualifikimit .

Njësia e prokurimit ka përcaktuar termat e referencës, kriteret e përgjithshme dhe kriteret e veçanta për kualifikim dhe ka bërë argumentimet për kriteret e vendosura për kualifikim. Ndër të tjera, në **Pikën 2** të Shtojcës 8 të DST "Kriteret e Veçanta të Kualifikimit", autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

- a) *Të paktën 2 (dy) specialistë të certifikuar Technical Professional (ose ekuivalente sipas prodhuesit përkatës) për zgjidhjen hardëare të ofruar, me minimum 3 vjet eksperience profesionale. mund të realizohet edhe nga 1 (një) specialist i vetëm i certifikuar.*
- b) *Të paktën 1 (një) person të certifikuar PMP ose ekuivalent për menaxhimin e projekteve (Certifikimi duhet të jetë aktiv, i verifikueshem në listën e publikuar nga PMI ose ekuivalent, dhe me minimumi 5 vjet experience)*
- c) *Të paktën 1 (një) specialist të certifikuar për SQL Database me minimumin 3 vjet eksperience profesionale.*
- d) *Operatori Ekonomik duhet të ketë status Gold (ose ekuivalent) për pajisjet harduerë të ofruara. Ky kriter provohet nëpërmjet dokumentacionit të lëshuar nga prodhuesi përkatës në emër të operatorit Ekonomik ose nëpërmjet link të faqes web të prodhuesit ku vërtetohet ky status.*

Përcaktimet e kriterëve të veçanta të kualifikimit të sipërcituara nuk janë kryer në përputhje me Pikën e të Nenit 2 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar në të cilin citohet se: "Qëllimi i këtij ligji është: c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomike në procedurat e prokurimit publik, Neni 30 'Kërkesat e cilësisë të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, ndryshuar në të cilin citohet se: "Certifikatat dhe etiketat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mos diskriminimit" dhe pikën 3 të Nenit 46 'Kualifikimi i ofertuesve të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar në të cilin citohet se: "Kërkesat për kualifikim duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm dhe në çdo rast të jenë sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik"

Me vendimin nr. 1018/1 datë 31.08.2020 KPP pezullon procedurën e prokurimit dhe ndalon kryerjen e veprimeve deri në shqyrtimin e ankesës së operatorit ekonomik "3" shpk. Operatori ka kërkuar anulimin e procedurës.

Me vendimin 356/3030 prot datë 03.09.2020 pas shqyrtimit të ankesës të dokumentacionit të dërguar nga operatori ekonomik ankimes KPP konstatoi se OE ankimes ka interes në këtë procedure prokurimi dhe legjitimohet të paraqiti ankesë. Në datën 01.09.2020 OE "3" ka

paraqitur pranë komisionit të Prokurimit Publik një kërkesë me anë të së cilës kërkon të heqë dorë nga ankesa e bërë në lidhje me procedurën e prokurimit. Lidhur me Kërkesën e OE, AKK gjykon se OE ankimues është në të drejtën e tij të kërkojë të heq dorë nga ankesa e paraqitur duke sjellë si rrjedhojë përfundimin e procedimit administrativ.

Zhvillimi i procedurës.

Përmes procesverbalit të hapjes së ofertave të datës 24.08.2020, të mbajtur në ambientet e Universitetit Ismail Qemal nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka kryer hapjen e ofertave ku rezultoi se për këtë procedurë kanë dorëzuar oferta 2 operatorë ekonomikë si më poshtë:

1. B dhe K shpk me ofertë **24,499,000 lekë**

2. "3" me ofertë **0 Lekë**

Në përfundim të shqyrtimit dhe vlerësimit të kriterëve të përgjithshme e të veçanta të kualifikimit, të dokumentacionit administrativo-ligjor, të specifikimeve teknike dhe mostrave, të ofertave të paraqitura për këtë procedurë rezultoi se 1 operatorë ekonomike nuk plotësoi kërkesat e vendosura në DT, e konkretisht: "3". Operatori B dhe K sh.p.k ka plotësuar kriteret e veçanta të kualifikimit, kapacitetin ligjor dhe teknik.

Likuidimi dhe zbatimi i kontratës.

Me urdhrin Nr.957/24 datë 02.12.2020 të Titullarit të Autoritetit kontraktor është ngritur komisioni për marrjen në dorëzim të mallrave dhe ndjekjen dhe realizimin e kontratës të përbërë nga E.Z, M.M dhe A.H.

Me datën 09.12.2020 me anë të urdhër shpenzimit 926 datë 09.12.2020 është bërë likuidimi pjesor i pagesës 17,121,861 lekë Me datën 01.04.2021 me urdhër shpenzimit 206 është kryer likuidimi përfundimtar 12,276,000 Lekë

Nga dokumentacioni paraqitur grupit të auditimit u konstatua se grupi i marrjes në dorëzim me anë të procesverbalit Nr.957/25 datë 09.12.2020 ka marrë në dorëzim vetëm infrastrukturën hardware (fizike) ndërsa struktura software nuk është marrë në dorëzim.

Pakti për Universitetin Ndërtimi i bibliotekave me standarde europiane dhe me libër universitar online falas për studentët në gjuhën shqipe

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se investimi për krijimin e kësaj bibliotekës dixhitale ka ardhur pas Paktit të Universitetit që Këshilli i Ministrave ka bërë për përmirësimin e kushteve të studenteve. Në muajin Prill 2019 u prezantua nga Kryeministri dhe ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Biblioteka Digjitale si një nga premtimet e "Paktit për Universitetin" që do të adresonte problematikën e kostove të blerjes së librave dhe do të rriste aksesin e studentëve në botime të ndryshme Universitare. Ndërtimi i një biblioteke online me standarde evropiane ishte një ndër kërkesat e studentëve.

Sipas Paktit për Universitetin citohet:.

Deri më sot, aksesin në librat dhe revistat shkencore ka qenë një veprimtari që lidhet drejtpërsëdrejti me vendimmarrjen autonome të Institucioneve të Arsimit të Lartë. Rezultoni se jo të gjithë Institucionet publike të Arsimit të Lartë kanë realizuar marrëveshje abonimi dhe për aksesueshmërinë në revista shkencore të lidhura me fushat përkatëse. Kjo situatë ka krijuar një boshllëk dhe mos përditësim me zhvillimet më të fundit shkencore. Në këtë kontekst, stafet pedagogjike dhe studentet hasin vështirësi për realizimin e objektivave universitare dhe përvetësimin e dijeve të nevojshme për zhvillimin e tyre Ndërtimi i Bibliotekave Me Standarde Evropiane Dhe Me Libër Universitar Online Falas Për Studentët Në Gjuhën Shqipe Mungesa e aksesit dhe mos përditësimi me zhvillimet më të fundit shkencore. Rritje të shpenzimeve të studentëve për blerjen e botimeve më të fundit shkencore për realizimin e detyrave të kursit.
Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, ka kontaktuar Qendrën Ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik Shqiptar (RASH), për të vlerësuar mundësinë e implementimit të bibliotekave elektronike. MASR do t'i akordojë një fond buxhetor të veçantë RASH, që

ka ngritur grupin teknik për përgatitjen e ToR për infrastrukturën hardware dhe middleware, të nevojshme për ngritjen e bibliotekës digjitale. RASH po shqyrton modelet më të përshtatshme për t'u vënë në zbatim, si dhe ka marrë kontakt me ofruesit ndërkombëtare të bibliotekave dhe të arkivave kërkimore në rang global. 2. Është miratuar Urdhrit nr. 183, datë 26.12.2018 i Kryeministrit "Për ngritjen e grupit ndërinstitucional për përzgjedhjen e literaturës së huaj që do të përkthehet, me qëllim përdorimin në Institucionet e Arsimit të Lartë". Në zbatim të këtij Urdhri, do të përditësohen dhe përmirësohen titujt akademike të IAL-ve.

Universiteti i Vlorës, ka nënshkruar krijimin e Rrjetit Akademik Shqiptar – RASH, mbështetur në këtë marrëveshje është miratuar VKM nr. 88, datë 14.02.2018 për "Krijimin e Qendrës Ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik Shqiptar".

Mbështetur në pikat 3/ç dhe 4/a, qëllimi i RASH:

- 3/ç: Është zhvillimi i programeve software dhe ofrimi i shërbimeve përkatëse për ministrinë përgjegjëse për arsimin, agjencitë e varësisë për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, institucionet e arsimit të lartë, të kërkimit shkencor dhe inovacionit e për të gjithë anëtarësinë e RASH-it, si dhe për palë të treta.

- 4/a: Kryen zhvillimin dhe ofrimin e sistemeve më të përparuara software për administrimin e procesit të aplikimit universitar, menaxhimin e proceseve akademiko-shkencore dhe administrative-universitare dhe platformave për formimin dhe testimin on-line për arsimin e lartë, në kuadër të rritjes së cilësisë në arsim dhe pjesëmarrjes në aktivitetet e kërkimit dhe të zhvillimit, të drejtuara nga komuniteti shkencor dhe arsimor ndërkombëtar

Nga shqyrtimi i dokumentacionit si dhe nga verifikimet e kryer gjatë auditimit, konstatohet që sipas grupit të auditimit investimi i kryer nga Universiteti Ismail Qemali me urdhër nr.957/1 datë 22.06.2020 të administratorit për bibliotekën dixhitale të caktuar me fond limit 24,999,000 lekë është pa efektivitet pasi qëllimi për realizim të këtij investimi është i njëjtë me investimin që do të realizohej nga RASH me fondet e MASR, në vitin 2019 nga ku përfitues është dhe Universiteti Ismail Qemali.

1.Titulli i Gjetjes: Nga auditimi i dokumentacionit të procedurës të prokurimit ***Krijimi i Datacenter dhe Ndërtimi i Sistemit të Integruar për menaxhimin e bibliotekës dixhitale*** rezulton se disa prej kërkesave e veçanta për kualifikim janë të mbivendosura dhe të panevojshme për zbatimin e kontratës.

Situata: Njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit mbështetur në specifikimet teknike dhe në fondin limit, ka hartuar dokumentet e këtij tenderit të "Hapur". Po kështu, ka hartuar dhe vendosur në këto dokumente përveç kriterëve ligjore të përgjithshme të pranim kualifikimit edhe kriteret e veçanta kualifikuese. Përmes formularit të ankesës pranë autoritetit kontraktor janë paraqitur 4 ankesa nga operatorë të ndryshëm. Në këto ankesa operatorët ekonomik kanë paraqitur argumentimet për kundërshtimin e kriterëve të kualifikimit .

Njësia e prokurimit ka përcaktuar termat e referencës, kriteret e përgjithshme dhe kriteret e veçanta për kualifikim dhe ka bërë argumentimet për kriteret e vendosura për kualifikim. Ndër të tjera, në **Pikën 2** të Shtojcës 8 të DST "Kriteret e Veçanta të Kualifikimit", autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

a) *Të paktën 2 (dy) specialistë të certifikuar Technical Professional (ose ekuivalente sipas prodhuesit përkatës) për zgjidhjen harduerë të ofruar, me minimum 3 vjet eksperience profesionale. mund të realizohet edhe nga 1 (një) specialist i vetëm i certifikuar.*

b) Të paktën 1 (një) person të certifikuar PMP ose ekuivalent për menaxhimin e projekteve (Certifikimi duhet të jetë aktiv, i verifikueshem në listën e publikuar nga PMI ose ekuivalent, dhe me minimumi 5 vjet experienceë

c) Të paktën 1 (një) specialist të certifikuar për SQL Database me minimumin 3 vjet eksperience profesionale.

d) Operatori Ekonomik duhet të ketë status Gold (ose ekuivalent) për pajisjet harduerë të ofruara. Ky kriter provohet nëpërmjet dokumentacionit të lëshuar nga prodhuesi përkatës në emër të operatorit Ekonomik ose nëpërmjet link të faqes web të prodhuesit ku vërtetohet ky status.

Nga auditimi u konstatua se kriteret e veçanta ka mbi vendosje kërkesash. AK ka kërkuar të paktën paktën 2 (dy) specialiste të certifikuar Technical Professional (ose ekuivalente sipas prodhuesit përkatës) dhe Te paktën 2 (dy) inxhinier elektronik me diplomim universitar me master ose ekuivalent me përvojë të paktën 3 vjeçare në fushën e pajisjeve elektronike. Për realizmin e këtij prokurimi mjafton nga 1(një) specialist (Technical Professional) ose nga 1(një) inxhinier elektronik me diplomim universitar me master ose ekuivalent me përvojë të paktën 3 vjeçare në fushën e pajisjeve elektronike për të bërë riparimet e mundshme nëse do paraqitet nevoja si dhe mbajtjen e garancisë të produkteve hardëare ,aq më tepër kur afati i zbatimit të kontratës është 120 ditë AK ka kërkuar:

-Te paktën 1 (një) specialist të certifikuar për SQL Database me minimumin 3 vjet eksperience profesionale kur nuk është kërkuar ngritja e një Database dhe konfigurimet mund të bëjë specialist i certifikuar për gjuhën e programimit të sistemit i cili s'ka nevojë për certifikatë SQL.

Kërkesa për Te paktën 1 (një) person të certifikuar PMP për menaxhimin e projekteve (Certifikimi duhet të jetë aktiv, i verifikueshem në listën e publikuar nga PMI, dhe me minimum 5 vjet eksperience është e panevojshme pasi nuk ka një projekt nga AK për ndjekjen e punimeve. Partenriteti zyrtar me Statusin Gold i kërkuar ndikon ndjeshëm në uljen e konkurrencës duke përjashtuar operatorët që konkurrojnë në treg, të cilët janë të lidhur me distributorë të ndryshëm ,pra kjo nuk do të thotë që ata nuk kanë kapacitetin për të realizuar procedurën në fjalë.

Përcaktimet e kriterëve të veçanta të kualifikimit të sipërcituara nuk janë kryer në përputhje me Pikën 2 të Nenit 1 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar në të cilin citohet se: "Qëllimi i këtij ligji është: c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomike në procedurat e prokurimit publik, Neni 30 'Kërkesat e cilësisë të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, ndryshuar në të cilin citohet se: "Certifikatat dhe etiketat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mos diskriminimit" dhe pikën 3 të Nenit 46 'Kualifikimi i ofertuesve të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar në të cilin citohet se: "Kërkesat për kualifikim duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm dhe në çdo rast të jenë sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik"

Me vendimin nr. 1018/1 datë 31.08.2020 KPP pezullon procedurën e prokurimit dhe ndalon kryerjen e veprimeve deri në shqyrtimin e ankesës së operatorit ekonomik "3" shpk. Operatori ka kërkuar anulimin e procedurës.

Me vendimin 356/3030 prot datë 03.09.2020 pas shqyrtimit të ankesës të dokumentacionit të dërguar nga operatori ekonomik ankimes KPP konstatoi se

OE ankimues ka interes në këtë procedure prokurimi dhe legjitimohet të paraqis ankesë. Në datën 01.09.2020 OE "3" ka paraqitur pranë komisionit të Prokurimit Publik një kërkesë me anë të së cilës kërkon të heqë dorë nga ankesa e bërë në lidhje me procedurën e prokurimit. Lidhur me Kërkesën e OE, AKK gjykon se OE ankimues është në të drejtën e tij të kërkojë të heq dorë nga ankesa e paraqitur duke sjellë si rrjedhojë përfundimin e procedimit admintrativ.

- Kriteri:** Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, neni 1 pika 2, ,neni 20 “Mos diskriminimi, neni 46 “kualifikimi i ofertuesve”, pika 3
VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 Neni 30 'Kërkesat e cilësisë Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, ndryshuar
- Ndikimi/Efekti:** Shmangia e konkurrencës në procedurat e prokurimit.
- Shkaku:** Mosrespektim i akteve ligjore e nënligjore të Prokurimit Publik për të hartimit të kriterëve të kualifikimit.
- Rëndësia:** E lartë
- Rekomandim:** Sektori prokurimeve, grupet e hartimit të kriterëve për kualifikim, të marrin masa që në të ardhmen, në hartimin e Dokumenteve Standarde të procedurave të prokurimit, të shmangin vendosjen e kriterëve diskriminuese për të krijuar kushtet e një konkurrence të lirë për pjesëmarrjen në tender të sa më shumë operatorëve ekonomik.

2.Titulli i Gjetjes: Përdorim i fondeve të Universitetit pa efektivitet, në vlerën **24,499,000 lekë pa TVSH** për procedurën e prokurimit ‘**Krijimi i Datacenter dhe Ndërtimi i Sistetmit të Integruar për menaxhimin e bibliotekës dixhitale**’.

Situata: Pakti për Universitetin Ndërtimi i bibliotekave me standarde evropiane dhe me libër universitar online falas për studentët në gjuhën shqipe
Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se investimi për krijimin e kësaj bibliotekës dixhitale ka ardhur pas Paktit të Universitetit që Këshilli i Ministrave ka bërë për përmirësimin e kushteve të studenteve. Në muajin Prill 2019 u prezantua nga Kryeministri dhe ministrja e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Biblioteka Digjitalë si një nga premtimet e “Paktit për Universitetin” që do të adresonte problematikën e kostove të blerjes së librave dhe do të rriste aksesin e studentëve në botime të ndryshme Universitare. Ndërtimi i një biblioteke online me standarde evropiane ishte një ndër kërkesat e studentëve. Sipas Paktit për Universitetin citohet:
*Deri më sot, aksesin në librat dhe revistat shkencore ka qenë një veprimtari që lidhet drejtpërsëdrejti me vendimmarrjen autonome të Institucioneve të Arsimit të Lartë. Rezulton se jo të gjithë Institucionet publike të Arsimit të Lartë kanë realizuar marrëveshje abonimi dhe për aksesueshmërinë në revista shkencore të lidhura me fushat përkatëse. Kjo situatë ka krijuar një boshllëk dhe mos përditësim me zhvillimet më të fundit shkencore. Në këtë kontekst, stafet pedagogjike dhe studentet hasin vështirësi për realizimin e objektivave universitare dhe përvetësimin e dijeve të nevojshme për zhvillimin e tyre Ndërtimi I Bibliotekave Me Standarde Evropiane Dhe Me Libër Universitar Online Falas Për Studentët Në Gjuhën Shqipe Mungesa e aksesit dhe mos përditësimi me zhvillimet më të fundit shkencore. Rritje të shpenzimeve të studentëve për blerjen e botimeve më të fundit shkencore për realizimin e detyrave të kursit. **Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, ka kontaktuar***

Qendrën Ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik Shqiptar (RASH), për të vlerësuar mundësinë e implementimit të bibliotekave elektronike. MASR do t'i akordojë një fond buxhetor të veçantë RASH, që ka ngritur grupin teknik për përgatitjen e ToR për infrastrukturën hardware dhe middleware, të nevojshme për ngritjen e bibliotekës digjitale. RASH po shqyrton modelet më të përshtatshme për t'u vënë në zbatim, si dhe ka marrë kontakt me ofruesit ndërkombëtare të bibliotekave dhe të arkivave kërkimore në rang global. 2. Është miratuar Urdhrit nr. 183, datë 26.12.2018 i Kryeministrit "Për ngritjen e grupit ndërinstitucional për përzgjedhjen e literaturës së huaj që do të përkthehet, me qëllim përdorimin në Institucionet e Arsimit të Lartë". Në zbatim të këtij Urdhri, do të përditësohen dhe përmirësohen titujt akademike të IAL-ve.

Universiteti i Vlorës, ka nënshkruar krijimin e Rrjetit Akademik Shqiptar – RASH, mbështetur në këtë marrëveshje është miratuar VKM nr. 88, datë 14.02.2018 për “Krijimin e Qendrës Ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik Shqiptar”.

Mbështetur në pikat 3/ç dhe 4/a, qëllimi i RASH:

- 3/ç: Është zhvillimi i programeve software dhe ofrimi i shërbimeve përkatëse për ministrinë përgjegjëse për arsimin, agjencitë e varësisë për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, institucionet e arsimit të lartë, të kërkimit shkencor dhe inovacionit e për të gjithë anëtarësinë e RASH-it, si dhe për palë të treta.

-4/a: Kryen zhvillimin dhe ofrimin e sistemeve më të përparuara software për administrimin e procesit të aplikimit universitar, menaxhimin e proceseve akademiko-shkencore dhe administrative-universitare dhe platformave për formimin dhe testimin on-line për arsimin e lartë, në kuadër të rritjes së cilësisë në arsim dhe pjesëmarrjes në aktivitetet e kërkimit dhe të zhvillimit, të drejtuara nga komuniteti shkencor dhe arsimor ndërkombëtar

Nga shqyrtimi i dokumentacionit si dhe nga verifikimet e kryer gjatë auditimit, konstatohet që sipas grupit të auditimit investimi i kryer nga Universiteti Ismail Qemali me urdhër nr.957/1 datë 22.06.2020 të administratorit për bibliotekën Dixhitale të caktuar me fond limit 24,999,000 lekë është pa efektivitet pasi qëllimi për realizim të këtij investimi është i njëjtë me investimin që do të realizohet nga RASH me fondet e MASR, në vitin 2019 nga ku përfitues është dhe Universiteti Ismail Qemali

Kriteri:

1.Pakti për Universitetin

2.VKM nr. 88, datë 14.02.2018 për “Krijimin e Qendrës Ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik Shqiptar”.

Ndikimi/Efekti:

Përdorim i fondeve të Universitetit pa efektivitet

Shkaku:

1.Nuk janë mbështetur tek marrëveshja e nënshkruar midis Rrjetit Akademik Shqiptar dhe Universitetit Ismail Qemali. Konkretisht:

4/a: Kryen zhvillimin dhe ofrimin e sistemeve më të përparuara software për administrimin e procesit të aplikimit universitar, menaxhimin e proceseve akademiko-shkencore dhe administrative-universitare dhe platformave për formimin dhe testimin on-line për arsimin e lartë, në kuadër të rritjes së cilësisë në arsim dhe pjesëmarrjes në aktivitetet e kërkimit dhe të zhvillimit, të drejtuara nga komuniteti shkencor dhe arsimor ndërkombëtar

2. Nuk janë mbështetur tek Pakti për Universitetin

Rëndësia:

E Lartë

Rekomandimi:	Administratori i Universitetit të marrë masa të analizojë mangësitë e konstatuara, në të ardhmen të miratojë realizimin e procedurave të prokurimit të cilat sjellin përmirësim dhe ndihmojnë në përmbushjen e misionit për stafin akademik dhe studentët e Universitetit.
3.Titulli i Gjetjes:	Nga auditimi dhe shqyrtimi i dokumentacionit të procedurës mplementimin e Datacenter dhe Sistemit të Integruar për menaxhimin e Biblotekës u konstatua se në procesverbalin e marrjes në dorëzim nuk janë evidentuar të gjitha mallrat e ardhur në magazinë
Situata:	Komisioni për marrjen në dorëzim të mallrave dhe ndjekjen dhe realizimin e kontratës të përbërë nga E.Z, M.M dhe A.H. Me datën 09.12.2020 me anë të urdhër shpenzimit 926 datë 09.12.2020 është bërë likuidimi pjesor i pagesës 17,121,861 lekë Me datën 01.04.2021 me urdhër shpenzimit 206 është kryer likuidimi përfundimtar 12,276,000 Lekë Nga dokumentacioni paraqitur grupit të auditimit u konstatua se me anë të procesverbalit Nr957/25 datë 09.12.2020 është marrë në dorëzim vetëm infrastruktura hardëare(fizike)
Kriteri:	Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 42,pika 45
Ndikimi/Efekti:	Mangësi në hartimin e kërkesave për nevojën e shërbimeve dhe mallrave, në procesin e marrjes në dorëzim të mallrave të furnizuara dhe shërbimeve.
Shkaku:	Mos respektimi i përcaktimeve ligjore e nënligjore
Rëndësia	E lartë
Rekomandimi:	Titullari i autoriteti kontraktor të marrë masa që në vijmësi grupet e caktuara për marrjen në dorëzim të mallrave dhe ndjekjen e kontratave të dokumentojnë në procesverbal të gjitha mallrat e prokuruar

Për sa është trajtuar në këtë pikë të Raportit Përfundimtar të Auditimit është mbajtur Aktkonstatimi nr. 2, datë 29.09.2022, protokolluar në Universitetin e Vlorës me nr. 585/7 datë 29.09.2022, si dhe është trajtuar në Projektraportin e Auditimit mbi të cilin janë paraqitur observacione me shkresën nr. 1855/4, datë 30.11.2022 protokolluar në UV nga zj O.GJ, z.E.N, z. F.H dhe me nr. 468/, datë 02.12.2022 protokolluar në KLSH. Objeksionet e ardhura në këtë fazë janë argumentuar dhe në fazën e Projek Raportit të auditimit.

Pretendimi i subjektit:

-Në pjesën "Përgatitja e dokumenteve të tenderit", (faqe 2), në lidhje me pikën 2/1 të shtojcës & te DST "Kriteret e Veçanta të Kualifikimit" ku është kërkuar: Te paktën 2 (dy) specialiste te certifikuar Technical Professional (ose ekuivalente sipas prodhuesit përkatës) për zgjidhjen hardware të ofruar, me minimum 3 vjet eksperience profesionale.

Grupi i Auditimit është shprehur: "mund te realizohet nga 1 (një) specialist i vetëm i certifikuar", ndërkohë që njësia e prokurimit me shkresën me Nr.957/2.Prot.. date 22.06.2020 miratuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor ka arsyetuar për domosdoshmërinë e vendosjes së këtij kriteri si më poshtë:

Për të vërtetuar që kompania ka në stafin e saj persona të kualifikuar për të bërë konfigurimet dhe riparimet në qoftë se do të ketë nevojë dhe gjatë periudhës së garancisë, Ky kriter vendoset bazuar në kërkesat e legjislacionit me sipër dhe duke pasur parasysh faktin që projekti/tenderi në fjale në shtojcën 9 "Specifikimet Teknike" nën zërin "Infrastrukturës Hardware" kërkon qartazi që sistemi të ketë shumë pajisje hardware dhe të parashikuara me F.V.(furnizim vendosje). Nisur dhe nga eksperiencia e procedurave të mëparshme krahasimisht të tilla, meqenëse niveli i kompleksitetit të vendosjes në punë të produkteve të kërkuara është mbi mesataren, atëherë domosdoshmërisht kërkohej minimalisht 2 persona me kualifikimin "Technical Profesional ose ekuivalent" që të bëjnë vendosjen e pajisjeve për herë të parë në punë sipas standardeve të prodhuesit respektiv që do ofrohet nga OE konkurrues konfigurimet e duhura dhe vijimin e çdo riparimi sipas standardit të prodhuesit përkatës dhe prandaj emërtimi i këtij certifikimi shoqërohet me termin "ekuivalent" pasi prodhues të ndryshëm botëror kanë emërtime dhe nivele të ndryshme certifikimesh personeli në nivelin Profesional. Prezenca e 2 specialisteve të tilla dhe koha e përvojës 3-vjeçare të këtyre specialisteve ndikohet nga madhësia e fondit limit, rëndësia e kompleksiteti i realizimit të projektit dhe gjykohej në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Kemi parasysh këtu dhe faktin që AK nuk ka në personelin e saj teknik 1 apo 2 specialiste me kualifikime të tilla të domosdoshme për realizimin dhe për të bërë riparimet e mundshme nëse do paraqitet nevoja si dhe mbajtjen e garancisë të produkteve hardware të kësaj kontrate, duke respektuar rekomandime të Prodhuesit respektiv.);

Konstatimi i Grupit të Auditimit është një konstatim subjektiv, pasi njësia e Prokurimit e ka bazuar vendosjen e këtij kriteri, në raport me procedurën, me anën teknike të zgjidhjes, peshës së madhe që mbart një punë e parametrave të tilla, duke qenë se për zgjidhjen Hardware, do të punohej në dy fronte të ndryshme njëkohësisht. Ju kujtojmë se paneli kryesor do të mendohej në zyrën e përcaktuar nga Autoriteti, brenda në ambientet e Rektoratit, ndërsa pajisjet e tjera do të instaloheshin në ambientet e Bibliotekës "Nermin Vlora Falaschi". ERST mundshëm të paktën dy specialistë, për implementimin e plotë dhe në përputhje me parametrat evropianë të të gjithë sistemit të kërkuar. Kujtojmë që ndërtimi i këtij sistemi informatikë, nuk do të kostojë pak, që do të thotë nuk mund ta lëmë punën në duart e një firme apo kompanie, e cila nuk përmban Për këtë duhet marrë në konsideratë që njësia e prokurimit ka kërkuar si minimumin e personelin e specializuar, për zbatimin me përgjegjëshmëri si në përmbajtje ashtu edhe në kohë. Mendojmë që kriteri i mësipërm nuk është një kriter diskriminues për operatorët ekonomikë potencialë, pasi gjykohej që një operator ekonomik apo bashkim operatorësh që ka eksperiencia të ngjashme me këto lloje infrastrukturash TIK me siguri ka në stafin e vet specialiste të tilla që madje mund të kenë disa certifikime dhe në këtë mënyrë plotësojnë dhe kritere të tjera të kualifikimi stafi me një numër me të kufizuar personash, për përmbushjen e kësaj kontrate edhe një subjekt që nuk i ka në stafin e tij specialistët e kërkuar, mund t'i kontraktojë si specialistë të jashtëm për përmbushjen e kësaj kontrate.

- Te paktën 1 (një) person të certifikuar PMP për menaxhimin e projekteve (Certifikimi duhet të jetë aktiv, i verifikueshëm në listën e publikuar nga PMI, dhe me minimum 5 vjet experience)

Ky kriter vendoset bazuar në kërkesat e legjislacionit dhe duke pasur parasysh faktin që madhësia, kompleksiteti dhe kohëzgjatja e zbatimit të kësaj procedure është e madhe (deri në 120 ditë nga nënshkrimi i kontratës) dhe fondi limit në dispozicion është relativisht i lartë dhe nga të ardhurat e veta të Universitetit. Përveç sa më lart, siguria dhe garantimi i ekzekutimit të suksesshëm në kohë sasi e cilësi i kësaj kontrate, detyron AK që të vendosë këtë kriter në mënyrë që kompetenca tekniko-profesionale e tij të arrijë suksesin në implementimin dhe qëllimin e kontratës. Koha e përvojës 5 vjeçare të këtij specialisti ndikohet nga madhësia e fondit limit, rëndësia e kompleksiteti i realizimit të projektit dhe

gjykohej ne përpjesëtim dhe te lidhura ngushte me objektin e kontratës, prandaj dhe është caktuar vetëm 1 person (minimum i mundshëm). Kemi parasysh këtu dhe faktin që AK nuk ka ne personelin e saj teknik një specialist me kualifikime te tilla te domosdoshme për realizimin e kësaj kontrate)

- Te paktën 1 (një) specialist te certifikuar për SQL Database me minimumin 3 vjet eksperiencë profesionale

Ky kriter vendoset bazuar ne kërkesat e legjislacionit me sipër dhe duke pasur parasysh faktin që projekti/tenderi ne fjale ne shtojcën 9 "Specifikimet Teknike" kërkon qartazi që sistemi te jete i bazuar ne databazen relacionale SQL. Ndaj domosdoshmerisht kërkohej minimalisht 1 person me kualifikimin për "SQL Database" që te beje menaxhimin e databazes se aplikacionit si pjese e sistemit te kërkuar dhe lihet e hapur marka e kesaj databaze për te mos kufizuar konkurrencën meqenëse ne rajonin tone dhe ne te gjithë boten ekzistojne disa marka databazash. Kemi parasysh këtu dhe faktin që AK nuk ka ne personelin e saj teknik një specialist me kualifikime te tilla te domosdoshme për realizimin e kësaj kontrate. Koha e përvojës 3-vjeçare te këtij

Specialisti ndikohet nga madhësia e fondit limit, rëndësia e kompleksiteti i realizimit te projektit dhe gjykohej ne përpjesëtim dhe te lidhura ngushte me objektin e kontratës, Prandaj dhe është caktuar vetëm 1 person. Kemi parasysh këtu dhe faktin që AK nuk SITE he personelin e saj teknik një specialist me kualifikime te tilla te domosdoshme për realizimin e kësaj kontrate.

3 - Operatori Ekonomik duhet te këtë status Gold (ose ekuivalent) për pajisjet hardware te ofertuar. Ky kriter te provohet nëpërmjet dokumentacionit te lëshuar nga prodhuesit përkatës ne emër te Operatorit Ekonomik ose nëpërmjet link te faqes Web te prodhuesit ku vërtetohet ky status.

Statusi "Gold" ose ekuivalent i tij për çdo OE konkurrent, tregon për qëndrueshmërinë marrëdhëniet me prodhuesin respektiv dhe reputacion te mire. Një kriter i tille do te vërtetonte që OE konkurrues do kishte suportin e drejtpërdrejte te prodhuesit, pasi ky status i jepet kompanive që kane kryer dhe vazhdojnë te kryejnë me sukses projektet e ndërmarra Përveçse i bazuar ne ligjet e mësipërme, vendosja e këtij kriteri ndikohet edhe nga madhësia e fondit limit, rëndësia e kompleksiteti i realizimit te projektit dhe gjykohej ne përpjesëtim dhe te lidhura ngushte me objektin e kontratës. Termi përdorur "ose ekuivalent" e hap/zgjeron mundësinë e konkurrencës pasi prodhues te ndryshëm botërore pajisesh TIK shpesh kane emërtime respektivisht ndryshe për te shprehur nivelin e bashkëpunimit me kompanitë respektive që kane rolin e OE. Niveli i larte i bashkëpunimit dhe reputacioni me prodhuesin respektiv jep garanci me shume për AK. që do te respektohen kushtet e garancisë dhe riparimet e mundshme gjate dhe pas periudhës se garancisë.

Në përmbyllje te relacionit tonë, Njësia e Prokurimit do të marrë masa të menjëhershme për të zbatuar rekomandimet Tuaja në procedurat që do të zhvillohen në vijim.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Në lidhje me observacionin e dërguar nga Njësia e Prokurimit sqarojmë se në kritere e veçantat të kualifikimit ju keni kërkuar :

- a) Te paktën 1 (një) person te certifikuar PMP për menaxhimin e projekteve (Certifikimi duhet te jete aktiv, i verifikueshëm ne listën e publikuar nga PMI, dhe me minimumi 5 vjet eksperience)
- b) Te paktën 1 (një) specialist te certifikuar për SQL Database me minimumin 3 vjet eksperience profesionale.
- c) Te paktën 1 (një) specialist te certifikuar për gjuhen e programimit te sistemit te ofertuar me minimumin 3 vjet eksperience profesionale.
- d) Te paktën 1 (një) specialist te certifikuar CCNA (ose ekuivalent) për konfigurimet e networkut te sistemit te ofertuar.

- e) Te paktën 1 (një) specialist te certifikuar për sisteme operimi (certifikata duhet te jete për sistemin e operimit qe do te përdoret)
- f) Te paktën 2 (dy) specialiste te certifikuar Technical Professional (ose ekuivalente sipas prodhuesit përkatës) për zgjidhjen hardware te ofruar, me minimum 3 vjet eksperience profesionale.
- g) Te paktën 1 (një) specialist te certifikuar Technical Professional (ose ekuivalente sipas prodhuesit përkatës) për zgjidhjen e virtualizimit ne nivelin data center nga prodhuesi i zgjidhjes se ofertuar, me minimum 3 vjet eksperience profesionale.
- h) Te paktën 2 (dy) inxhinier elektronik me diplomim universitar me master ose ekuivalent me përvojë te paktën 3 vjeçare ne fushën e pajisjeve elektronike

Grupi i auditimit është shprehur se në kriteret e veçanta ka mbi vendosje kërkesash: Ju keni kërkuar të paktën paktën 2 (dy) specialiste te certifikuar Technical Professional (ose ekuivalente sipas prodhuesit përkatës) dhe Te paktën 2 (dy) inxhinier elektronik me diplomim universitar me master ose ekuivalent me përvojë te paktën 3 vjeçare ne fushën e pajisjeve elektronike për realizimin e këtij tenderi mjafton nga 1(një) specialist për realizimin dhe për te bere riparimet e mundshme nëse do paraqitet nevoja si dhe mbajtjen e garancisë te produkteve hardëare ,aq më tepër kur afati i zbatimit të kontratës është 120 ditë

Keni kërkuar:

-Te paktën 1 (një) specialist te certifikuar për SQL Database me minimumin 3 vjet eksperience profesionale kur nuk është kërkuar ngritja e nje Database dhe kur konfigurimet mund ti bëjë specialist i certifikuar për gjuhen e programimit te sistemit i cili s'ka nevojë për certifikatë SQL. Kërkesa për Te paktën 1 (një) person te certifikuar PMP për menaxhimin e projekteve (Certifikimi duhet te jete aktiv, i verifikueshëm ne listën e publikuar nga PMI, dhe me minimum 5 vjet eksperience është e panevojshme pasi nuk ka një projekt nga AK për ndjekjen e punimeve. Partenriteti zyrtar me Statusin Gold i kërkuar ndikon ndjeshëm në uljen e konkurrencës duke përjashtuar operatorët që konkurrojnë në treg, të cilët janë të lidhur me distributorë të ndryshëm ,pra kjo nuk do të thotë që ata nuk kanë kapaciteti për të realizuar procedurën në fjalë.

Për sa më sipër grupi auditimit mban të njëjtin qëndrim.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit janë paraqitur observacione me shkresë nr. 468/13 datë 24.11.2022 dhe shkresën nr 1855 datë 24.11.2022 protokullar në KLSH me Nr.468/17 "Mbi Projekt Raportin e Auditimit" nga ish Administratori i Universitetit Ismail Qemali M.D, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i ish Administratorit të Universitetit Ismail Qemali:

Referuar aktit Tuaj , më lejoni që të parashtroj komentet dhe shpjegimet me këtë shkresë ,për sa akti Juaj e kërkon

- Në kuadër të Planit Strategjik institucional 2018-2024 , pjesa Skenarët e zhvillimit në planin afatmesëm dhe afatgjatë: ,pjesa Skenari 2 i zhvillimit "SMART UV " ,që përfshin Edukimin Smart ,Sistem Shërbimesh Smart ,Infrastrukturë Smart është ideuar ,zhvilluar ,elaboruar projekti "Bibliotekës Dixhitale" ,që ka për qëllim dixhitalizimin e shërbimeve bibliotekare kundrejt stafit dhe studentëve, nëpërmjet dixhitalizimit të gj ithtë materialit bibliotekar(libra ,revista ,punime shkencore ,botime etj) që ka inventarin e vet institucioni Universiteti "Ismail Qemali " Vlorë nëpërmjet procesit të skanimit ,ruajtjes ,përpunimit ,dokumentimit
- Janë investime të ndryshme ,me qëllime të ndryshme ,nga institucione autonome të ndryshme. IAL në bazë të ligjit 80/2015 gëzojnë autonomi të plotë financiare me vendimmarrje organesh kolegjiale Senat Akademik dhe Bord Administrimi për veprimtarinë institucionale ,në mbështetje të lirisë akademike

- Nuk ka asnjë vendim të organeve kolegjiale Senat Akademik apo Bord Administrimi që mandaton Rektorin për nënshkrim të marrëveshjeve me RASH apo përfitim shërbimesh nga RASH deri në datë 12.01.2020
- Marrëdhëniet e mia të punës me institucionin janë shkëputur në mënyrë të menjëhershme në datë 12.01.2020 ,ndërkohë vet pohoni në material që asnjë nga administratorët pasardhës (ligjërisht 2 përfaqësues të tjerë pjesë e kësaj procedure dhe zbatimi kontrate)nuk ka ndjekur dhe zbatuar Udhëzimin nr 30 " Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik" dhe kërkuesi investimit Rektori me Drejtoritë në vartësi të vet nuk ka ndjekur detyrën. Kontrata është ndjekur dhe realizuar nga administratorët pasardhës. Firmat e tyre në dokumentacionet ligjore të institucionit I keni përmendur në materialin tuaj zyrtar.
- Efektiviteti i investimit lidhet me mos zbatueshmërinë dhe neglizhencën institucionale të detyrimeve kontraktuale dhe objektivave institucional. Ligji e përcakton qartë që u ngarkohet personave në detyrë .Ndërkohë ,në fund të vitit buxhetor 2022 ,sipas jush i ngarkohet si përgjegjësi ish titullarit ,që ka shkëput marrëdhëniet që në 12.01.2020 ,kohë në të cilën ishte realizuar vetëm procedura.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Kontrolli i Lartë i Shtetit ka realizuar Projektin e Auditimit” Auditim i Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit”, në Universitetin e Vlorës “Ismail Qemali”

Projekti i Auditimit ka objekt: “Auditimi i Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit”, për periudhën 01.01.2020 deri më 31.12.2021. Auditimi është realizuar nga Departamenti i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit. Grupi auditimit në auditimin e Teknologjisë së Informacionit në Universitetin Ismail Qemali është bazuar në Ligjin Nr. 154/2014 për kontrollin e Lartë Shtetit. Procedura e audituar është e trajtuar si investim pa efektivitet pasqyruar dhe në akt konstatim konkretisht:

Investimi për krijimin e kësaj bibliotekës dixhitale ka ardhur pas Paktit të Universitetit që Këshilli i Ministrave ka bërë për përmirësimin e kushteve të studenteve. Në muajin Prill 2019 u prezantua nga Kryeministri dhe ministrja e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Biblioteka Digjitalë si një nga premtimet e “Paktit për Universitetin” që do të adresonte problematikën e kostove të blerjes së librave dhe do të rriste aksesin e studentëve në botime të ndryshme Universitare. Ndërtimi i një biblioteke online me standarde evropiane ishte një ndër kërkesat e studentëve.

Sipas Paktit për Universitetin citohet:

Deri më sot, aksesin në librat dhe revistat shkencore ka qenë një veprimtari që lidhet drejtpërsëdrejti me vendimarrjen autonome të Institucioneve të Arsimit të Lartë. Rezulton se jo të gjithë Institucionet publike të Arsimit të Lartë kanë realizuar marrëveshje abonimi dhe për aksesueshmërinë në revista shkencore të lidhura me fushat përkatëse. Kjo situatë ka krijuar një boshllëk dhe mos përditësim me zhvillimet më të fundit shkencore. Në këtë kontekst, stafet pedagogjike dhe studentet hasin vështirësi për realizimin e objektivave universitare dhe përvetësimin e dijeve të nevojshme për zhvillimin e tyre Ndërtimi I Bibliotekave Me Standarde Evropiane Dhe Me Libër Universitar Online Falas Për Studentët Në Gjuhën Shqipe Mungesa e aksesit dhe mos përditësimi me zhvillimet më të fundit shkencore. Rritje të shpenzimeve të studentëve për blerjen e botimeve më të fundit shkencore për realizimin e detyrave të kursit. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, ka kontaktuar Qendrën Ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik Shqiptar (RASH), për të vlerësuar mundësinë e implementimit të bibliotekave elektronike. MASR do t'i akordojë një fond buxhetor të veçantë RASH, që ka ngritur grupin teknik për përgatitjen e ToR për infrastrukturën hardware dhe middleware, të nevojshme për ngritjen e bibliotekës digjitale. RASH po shqyrton modelet më të përshtatshme për t'u vënë në zbatim, si dhe ka marrë kontakt me ofruesit ndërkombëtarë të bibliotekave dhe të arkivave kërkimore në rang global. 2. Është miratuar Urdhrit nr. 183, datë 26.12.2018 i Kryeministrit "Për ngritjen e grupit ndërinstitucional për përzgjedhjen e literaturës së huaj që do të përkthehet, me qëllim

përdorimin në Institucionet e Arsimit të Lartë”. Në zbatim të këtij Urdhri, do të përditësohen dhe përmirësohen titujt akademike të IAL-ve.

Universiteti i Vlorës, ka nënshkruar krijimin e Rrjetit Akademik Shqiptar – RASH, mbështetur në këtë marrëveshje është miratuar VKM nr. 88, datë 14.02.2018 për “Krijimin e Qendrës Ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik Shqiptar”.

Mbështetur në pikat 3/ç dhe 4/a, qëllimi i RASH:

-3/ç: Është zhvillimi i programeve software dhe ofrimi i shërbimeve përkatëse për ministrinë përgjegjëse për arsimin, agjencitë e varësisë për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, institucionet e arsimit të lartë, të kërkimit shkencor dhe inovacionit e për të gjithë anëtarësinë e RASH-it, si dhe për palë të treta.

-4/a: Kryen zhvillimin dhe ofrimin e sistemeve më të përparuara software për administrimin e procesit të aplikimit universitar, menaxhimin e proceseve akademiko-shkencore dhe administrative-universitare dhe platformave për formimin dhe testimin on-line për arsimin e lartë, në kuadër të rritjes së cilësisë në arsim dhe pjesëmarrjes në aktivitetet e kërkimit dhe të zhvillimit, të drejtuara nga komuniteti shkencor dhe arsimor ndërkombëtar

Nga shqyrtimi i dokumentacionit si dhe nga verifikimet e kryer gjatë auditimit, konstatohet që sipas grupit të auditimit investimi i kryer nga Universiteti Ismail Qemali me urdhër nr.957/1 datë 22.06.2020 të administratorit për bibliotekën Dixhitale të caktuar me fond limit 24,999,000 lekë është pa efektivitet pasi qëllimi për realizim të këtij investimi është i njëjtë me investimin që do të realizohej nga RASH me fondet e MASR, në vitin 2019 nga ku përfitues është dhe Universiteti Ismail Qemali

Projektet janë parashikuar të kryejnë të njëjtin qëllim.

Në lidhje me pretendimin e paraqitur në observacion nuk është bashkëlidhur dokument justifikues. Për sa më sipër grupi i qëndron konstatimit të tij. Për sa më sipër grupi i auditimit mban të njëjtin qëndrim.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi:

- *zj.M.D ish Titullare e Autoritetit Kontraktor*
- *zj.O.GJ në cilësinë e anëtares së njësisë së prokurimit*
- *zj F.LL në cilësinë e anëtares së njësisë së prokurimit*
- *z.E.N në cilësinë e anëtarit së njësisë së prokurimit*

Procedura Pagesë Hostim Faqe dhe Abonim Soft për Detektimin e Plagjiaturës.

Nga auditimi i dokumentacionit të procedurës së prokurimit, **“Pagesë Hostim Faqe”** 119,021 Lekë dhe **Abonim Soft Per Detektimin e Plagjiatures** në vlerën 292,296 Lekë janë konstatuar mangësi në zhvillimin e procedurave. Procedurat e prokurimit, “Pagesë Hostim Faqe” dhe Abonim Soft për Detektimin e Plagjiaturës , blerje e vogël, nuk janë bazuar ne Ligjin e Prokurimit Publik për prokurimin e tyre. Sipas VKM nr. 914, datë 29.12.2014 neni 40 pika 4 *Në rastin kur procedura e prokurimit me vlerë të vogël zhvillohet në rrugë shkresore, anëtarët e komisionit testojnë tregun për të marrë tregues për çmimet e punëve/mallrave/shërbimeve, të cilat i pasqyrojnë në një procesverbal të mbajtur dhe të nënshkruar nga komisioni. Bazuar në kriterin e çmimit më të ulët, komisioni përcakton fituesin. Anëtarët e komisionit i drejtohen operatorit ekonomik, që ka ofruar çmimin më të ulët dhe bëjnë blerjen e mallrave, kryerjen e punëve ose të shërbimeve. Gjatë procedurës duhet të mbahet procesverbal, i cili nënshkruhet nga të gjithë zyrtarët e përfshirë në proces, duke i bashkëlidhur faturat përkatëse tatimore*

4.Titulli i Gjetjes:	Nga auditimi dhe shqyrtimi i dokumentacionit të procedurave të prokurimit me objekt Pagese Hostim Faqe” dhe Abonim Soft për Detektimin e Plagjiaturës rezulton se nuk janë testuar çmimet e tregut për mallra e shërbime në përputhje VKM Nr. 914, datë 29.12.2014, ‘Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik’.
Situata:	Procedurat e prokurimit, “Pagesë Hostim Faqe” me vlerë 119,021 Lekë dhe Abonim Soft për Detektimin e Plagjiaturës në vlerën 292,296 Lekë, blerje e vogël, nuk janë bazuar ne Ligjin e Prokurimit Publik për prokurimin e tyre. Sipas VKM nr. 914, datë 29.12.2014 neni 40 pika 4 <i>Në rastin kur procedura e prokurimit me vlerë të vogël zhvillohet në rrugë shkresore, anëtarët e komisionit testojnë tregun për të marrë tregues për çmimet e punëve/mallrave/shërbimeve, të cilat i pasqyrojnë në një procesverbal të mbajtur dhe të nënshkruar nga komisioni. Bazuar në kriterin e çmimit më të ulët, komisioni përcakton fituesin. Anëtarët e komisionit i drejtohen operatorit ekonomik, që ka ofruar çmimin më të ulët dhe bëjnë blerjen e mallrave, kryerjen e punëve ose të shërbimeve. Gjatë procedurës duhet të mbahet procesverbal, i cili nënshkruhet nga të gjithë zyrtarët e përfshirë në proces, duke i bashkëlidhur faturat përkatëse tatimore</i>
Kriteri:	VKM nr. 914, datë 29.12.2014 neni 40 pika 4
Ndikimi/Efekti:	Shmangia e konkurrencës
Shkaku:	Mosrespektim i akteve ligjore e nënligjore të Prokurimit Publik
Rëndësia	E Lartë
Rekomandim:	Universiteti Ismail Qemali të marrë masa që nga ana e grupeve të punës që do të ngrihen për procedurat e prokurimit që do të zhvillohen në të ardhmen në rastin kur procedura e prokurimit me vlerë të vogël zhvillohet në rrugë shkresore, anëtarët e komisionit të testojnë tregun për të marrë tregues për çmimet e punëve/mallrave/shërbimeve, të cilat i pasqyrojnë në një procesverbal të mbajtur dhe të nënshkruar nga komisioni.

3. Mbi Auditimin e Sigurisë së Informacionit, në Universitetin e Vlorës.

Sistemet e informacionit janë bashkime komplekse të teknologjisë, proceseve dhe njerëzve që funksionojnë së bashku për të rregulluar përpunimin, ruajtjen, dhe transferimin e informacionit për të mbështetur misionin e institucionit dhe funksionet e tij.

Siguria e informacionit është bërë gjithnjë e më shumë e rëndësishme për institucionet, kjo vjen si pasojë e rritjes së kompleksitetit të kontrollit të aksesit dhe ruajtjes së konfidencialitetit, integritetit dhe gatishmërisë së të dhënave nga marrëdhëniet e rrjeteve publike me ato private dhe nga bashkëpërdorimi i burimeve të informacionit. Siguria e Informacionit mund të përcaktohet si metoda e një sistemi për të mbrojtur informacionin dhe burimet e sistemeve në përputhje me kushtet e konfidencialitetit, integritetit dhe gatishmërisë.

Lidhur nga sa më sipër, çdo institucion publik shtetëror që ofron shërbime ndaj qytetarëve e ka si detyrim ndërtimin e programit të sigurisë së informacionit me elementët kyç të cilët janë: “Mjedisi i sigurisë së informacionit, Vlerësimi i riskut, Politikat e sigurisë, Organizimi i sigurisë së TI, Menaxhimi i komunikimeve dhe operacioneve, Menaxhimi i aseteve, Siguria e

burimeve njerëzore, Siguria fizike dhe mjedisore, Kontrolli i aksesit, Menaxhimi i incidenteve të sigurisë së TI”.

a. Siguria e të dhënave dhe vazhdimësia në ofrimin e shërbimit

Bazuar në standardet ndërkombëtare, siguria e informacionit garantohet duke siguruar gatishmërinë, konfidencialitetin dhe integritetin e të dhënave. Menaxhimi i log-eve ndihmon institucionin publik pasi nëpërmjet kësaj gjurme sigurohet informacioni mbi sigurinë që të ruhet me detaje dhe për një kohë të mjaftueshme. Analizat e log-eve mundësojnë identifikimin e incidenteve, aktivitetëve mashtruese, thyerjen e politikave, problemet operacionale pak pasi ato ndodhin. Ato gjithashtu ndihmojnë në hetimin e ngjarjeve të ndryshme, auditimin dhe ndihmojnë institucionin në problemet e brendshme.

Procedura e backup-it

Qëllimi i procedurës së kryerjes së backup-it të sistemeve në përdorim është që të sigurojë metoda dhe procedura të standardizuara mbi këto procese, duke siguruar kështu ruajtjen e të dhënave të serverave dhe mundësimin e rikthimit të këtyre të dhënave në raste të defekteve kritike ose rasteve të tjera të humbjes së të dhënave.

Procedura e hartuar/e ndjekur nuk është e pasqyruar apo e dokumentuar në ndonjë dokument administrativ si Rregullore e Brendshme apo dokument tjetër TIK ku të përcaktohet mënyra e kryerjes së backup-ve, procesin e ruajtjes së të dhënave për sistemet në përdorim nga punonjësit e Universitetit.

-Duke qenë se UV për sistemin UVMS nuk kanë sisteme të hostuara në ambientet e universitetit dhe nuk kanë pajisje hardware për këtë sistem si dhe duke qenë se ky sistem është i hostuar në një datacenter në Gjermani duke përdorur platformën Cloud VPS, për procedurat e back up nuk ka të dokumentuar ndonjë dokument administrativ si Rregullore e Brendshme apo dokument tjetër TIK ku të përcaktohet mënyra e kryerjes së backup-ve.

Për sistemin UVMS që është i hostuar në një platformë private jashtë shteti, nga kompania hostuese performohen 2 lloje backup. Procesi i parë është Snapshot të çastit të makinës virtuale e cila mban sistemin operativ dhe aplikacionet përkatëse. Backup automatik me snapshot për server i cili gjeneron 5 snapshot në ditë të cilat japin mundësi për rikthim të informacionit në gjendjen fillestare. Procesi i dytë është backup manual lokal që konsiston në shkarkimin e bazës së të dhënave në formatin e kompresuar .sql (non human readable) në një pajisje kompjuterike. Komunikimi me serverin e hostuar realizohet nëpërmjet aksesit me SSL që e bën të enkriptuar komunikimin dhe transferimin e të dhënave.

-Edhe për sistemin biblioteka dixhitale e cila është e hostuar në një dhomë të përshtatur në ambientet e rektoratit nuk ka të dokumentuar asnjë dokument administrativ si Rregullore e Brendshme apo dokument tjetër TIK ku të përcaktohet mënyra e kryerjes së backup-ve. Ky sistem akoma nuk është implementuar plotësisht pasi popullimi i informacionit akoma nuk ka përfunduar.

Active Directory

Nga auditimi i sigurisë së të dhënave që UV administron në sistemin e saj rezulton se: Siguria e rrjetit të UV është e kompromentuar pasi nuk ka Active Directory dhe Domain Controller për një identifikim të qëndrueshëm dhe sigurtë. Pa Active Directory, çdo kompjuter në rrjet ka bazën e të dhënave të veta të vogla të emrave të përdoruesve dhe fjalëkalimeve. Microsoft e quan këtë lloj krijimi një GRUP PUNE (WORKGROUP), domethënë çdo kompjuter vepron më vete dhe nuk ka kontroll qendror. Ky lloj konfigurimi krijon një sfidë kur kemi shumë kompjutera dhe një përdorues duhet të ketë qasje në njërin prej tyre ose kur ai ndryshon fjalëkalimin ose emrin e përdoruesit. Active Directory mban në një memorie të centralizuar, emrat, përdoruesit dhe

fjalëkalimet. Çdo ndryshim në emrat e përdoruesit dhe fjalëkalimet regjistrohen nga Active Directory dhe të gjithë kompjuterët në rrjet kanë qasje në këtë informacion. Prandaj Active Directory:

- Është një bazë të dhënash;
- Siguron kontroll të centralizuar;
- Regjistron të gjitha ndryshimet e fjalëkalimeve;
- Mund të shpërndalet në të gjithë botën;
- Ruan burimet në share folders
- Shërbimet si email mund të përdorin Active Directory.

Administratorët e rrjetit e përdorin Active Directory për të ruajtur dhe organizuar objekte në një rrjet (të tilla si përdoruesit, kompjuterët, pajisjet, etj.) Në një strukturë të sigurt hierarkike të kontrollit që njihet si strukturë logjike.

Nga administrimi i dokumentacionit u konstatua se UV për menaxhimin e userave, pajisjeve dhe aplikacioneve dhe për një identifikim të qëndrueshëm të sigurt të kontrollit dhe menaxhimin e shërbimeve në përputhje me standardet nuk ka ngritur Active Directory.

Ngritja e një Active Directory për UV do të thotë, krijim dhe logimin e përdoruesve të administratës së UV dhe marrjen e shërbimeve me anë të një autentifikimi të vetëm “single sign in”. Përdoruesit mund të logohen me adresën e emailit në pc, në email, në rrjet e etj me anë të domain controller-it duke patur një autentifikim të sigurt. Me anë të “single sign in” përdoruesit mund të logojnë:

- në PC;
- në network (wifi me pajisjet, laptop, smartphone, tablet, etj);
- në email;
- në apps;
- etj.

Duke krijuar usera manualisht, konfigurimin e emaileve për çdo user në mënyrë manuale dhe ruajtjen e të dhënave të përdoruesve në pc e tyre pa kontroll të qëndrueshëm rrezikon kompromentimin e sigurisë së infrastrukturës network në UV.

Konkluzion:

Nga administrimi i dokumentacionit u konstatua se UV nuk ka ngritur Active Directory për menaxhimin e userave, pajisjeve, aplikacioneve dhe marrjen e shërbimeve me anë të një autentifikimi të vetëm “single sign in” për një identifikim të qëndrueshëm të sigurt të kontrollit dhe menaxhimin e shërbimeve në përputhje me standardet me të mira. Në opinionin e grupit të auditimit përdorimi i një zgjidhje të tillë do të sillte lehtësira për stafin e UV në procesin e punës si dhe rritjen e sigurisë së të dhënave.

Mbi verifikimin e dokumentimit të planeve për vazhdueshmërinë e biznesit dhe rimëkëmbjes nga katastrofat.

Auditimi mbi planin e vazhdueshmërisë së biznesit u bazua mbi VKM nr. 710, datë 21.08.2013 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit”, risqeve të identifikuara dhe praktikave më të mira. Referuar kësaj VKM-je, çdo institucion që ka ose do të zhvillojë sisteme në fushën e teknologjisë së informacionit, me qëllim ofrimin e shërbimeve tek qytetarët, për biznesin dhe për ndërveprim e shkëmbim informacioni për administratën publike nëpërmjet këtyre sistemeve, duhet të parashikojë dhe të marrë masat e nevojshme për krijimin e sistemit të vazhdueshmërisë së punës dhe sistemit të ruajtjes së informacionit, me qëllim mundësimin e ofrimit të shërbimit pa ndërprerje dhe parandalimin e humbjes ose shkatërrimit të të dhënave. Universiteti i Vlorës, si institucion publik i arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor që posedon sistemin UVMS (*Sistemi i menaxhimit të informacionit mësimor të UV*), që ruan, përpunon dhe gjeneron të dhëna me rëndësi për menaxhimin dhe organizimin e procesit dhe kontrollin e

mësimdhënies si dhe procesin e pranimit, regjistrimit dhe ofrimit të shërbimeve për studentët, nuk ka marrë masa sa më poshtë.

Nga auditimi u konstatua ses UV :

- Nuk disponon dokument të planeve të vazhdueshmërisë së punës (BCP) dhe një plan të rikuperimit nga katastrofa (disaster recovery) me qëllim garantimin e vazhdueshmërisë së ofrimit të shërbimeve në raste të jashtëzakonshme emergjencash në kundërshtim me pikën 1 shkronja c) dhe ç), të VKM nr. 710, datë 21.08.2013 “*Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit*”, i ndryshuar. Këto dokumente përcaktojnë masat, procedurat dhe objektivat të mirë dokumentuara për rivendosjen në funksionim të sistemit në rastet e emergjencave dhe që sigurojnë vazhdueshmërinë e punës së sistemeve si dhe përcaktimin e RTO (*Objektivat e Kohës së Rimëkëmbjes*) dhe RPOs (*Objektivat e Punës së Ripërtërimit*) për çdo proces kritik.
- Siguria e informacionit mbart risqe që vijnë ngaqë programet e instaluar në kompjuterat e pajisjet e UV nuk janë të gjitha të licencuara dhe nuk kanë versionet të përditësuara si dhe përdorin për mbrojtje antivirus free me mbrojtjeje të kufizuar ose nuk përdorin fare antivirus.

Kontrollet e aksesit politikat e aksesit menaxhimi i privilegjeve përdorimi i TI në krijimin e kushteve fizike në UV.

Posedimi i kontrollit të aksesit është i rëndësishëm kur personat kërkojnë në informacion ose pajisje të rëndësishme, konfidenciale ose sensitive. Në një mjedis shtetëror, kontrolli i aksesit është i rëndësishëm sepse shumë subjekte publike përpunojnë të dhëna sensitive dhe çështjet e privatësisë limitojnë se cilët persona duhet të shohin pjesë të ndryshme të informacioni.

Politikat e aksesit japin një bazë për kontrollin e ndërhyrjes ndaj informacioneve të institucionit. Funksioni i Sigurisë së Informacionit monitoron efektivitetin e kontrollit të operacioneve të menaxhimit të llogarive të përdoruesve në kohë dhe raporton eficientë dhe efektivitetin e operimit.

Nga auditimi u konstatua se në hyrjen kryesore të Rektoratit të UV është instaluar një sistem i veçantë aksesit për hyrje daljet e punonjësve të UV por ky sistem nuk është funksional dhe nuk përdoret për të monitoruar hyrje-daljet, duke kompromentuar nivelin e sigurisë së aksesit në ambientet e saj me qëllim kufizimin e aksesit fizik të personave të paautorizuar.

Menaxhimi i Incidenteve dhe Problemeve

Për periudhën e audituar, në mungesë të procedurave të shkruara, risqet menaxhohen mbi bazë ngjarjesh. Suporti dhe mbështetja teknike dhe logjike për operacionet IT që ndihmojnë mbarëvajtjen e strukturave të institucionit kryhen nëpërmjet shkëmbimeve verbale dhe nëpërmjet e-mail-eve. Nga auditimi u konstatua se institucioni nuk ka politika të ruajtjes së dokumenteve dhe nuk ka të dokumentuar një plan masash për identifikimin, trajtimin e problemeve dhe incidenteve që mund të ndodhin në infrastrukturën IT. Duke mos realizuar identifikimin e risqeve, universiteti rrezikon që risqet të përsëriten dhe mënyra dhe koha e zgjidhjes së tyre është e papërcaktuar duke rrezikuar mbarëvajtjen e punës së sistemeve, ndërprerjen e shërbimeve etj. Identifikimi i risqeve çon në gjetjen e zgjidhjeve për t'i trajtuar ato dhe për të parandaluar ndodhjen e incidenteve të ngjashme në të ardhmen dhe në mënyrë që funksionet e institucionit të jenë të mbrojtura.

Mungesa e masave dhe mungesa e rregullores për trajtimin e incidenteve bën që institucioni të mos identifikojë risqet me efekt negativ në IT dhe në proceset e punës si dhe sjell mos dokumentim dhe mos lënie gjurmësh për trajtimin e gabimeve ose incidenteve nga punonjësit e IT.

-Menaxhimi i ndryshimeve.

Nga auditimi u konstatua se UV nuk disponon procedura për inicimin, rishikimin dhe aprovimin e ndryshimeve, ndarjen e detyrave dhe përgjegjësi për kryerjen e ndryshimeve.

b. Verifikimi i shkallës së sigurisë fizike dhe aksesit në rrjet

Verifikimi i shkallës së sigurisë së dhomës së serverëve me qëllim, parandalimin e vjedhjes ose të dëmtimit të pajisjeve kompjuterike, aksesit të paautorizuar, kopjimit ose shikimit të informacionit sensitiv.

Ambienti fizik i dhomës së serverëve për sistemin e bibliotekës dixhitale

Auditimit mbi shkallën e sigurisë së dhomës së serverëve, u krye në bazë të manualit të auditimit IT, ISSAI 5310 dhe ISO 27001 si dhe rregullores për ndërtimin e dhomës së serverëve (versioni 1.0, datë 02.12.2008) miratuar nga AKSHI, që parashikon përcaktimin e standardeve të TIK për administratën publike.

Duke qenë se dhoma e serverëve është pika më delikate e një sistemi informatik dhe përqendrimi i pajisjeve kompjuterike, mekanike, elektrike dhe elektronike është më i lartë se në ambientet e tjera të punës. Dëmet eventuale të shkaktuara në këtë ambient do të sillnin probleme serioze në funksionimin e të gjithë sistemit.

Për këtë qëllim, grupi i auditimit, të shoqëruar nga personat përgjegjës të IT në UV, zhvilloi verifikimin e dhomës së serverëve të lokalizuar në katin e parë të Rektoratit ku është hostuar rack-u me serverat e sistemit biblioteka dixhitale.

Nga auditimi u konstatua se:


Ambienti fizik i dhomës së serverëve ku është hostuar serveri i sistemit biblioteka dixhitale nuk është në përputhje me standardet e përcaktuara në rregulloren për ndërtimin e dhomës së serverëve (Versioni 1.0, datë 02.12.2008) miratuar nga AKSHI (Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit), përkatësisht:

Nga auditimi i kushteve dhe karakteristikave teknike të ndërtimit të dhomës së serverit u konstatua se:

- a. Muret e dhomës së serverëve dhe nuk garantojnë sigurinë fizike, nuk janë të izoluar nga zhurmat, nxehtësia dhe nuk ka skermo kundër emetimeve të valëve elektromagnetike (Kafazi Faraday);
- b. Dhoma nuk përbëhet nga një dyshe teknologjike në të cilën të jetë e parashikuar pesha e rack-eve dhe pajisjeve të tjera të cilat mund të vendosen në të dhe nuk ka pendence në drejtim të derës së dhomës së serverëve;
- c. Dhoma e serverëve nuk është e pajisur me një sistem të përshtatshëm kundër zjarrit;
- d. Dhoma e serverëve nuk përmban kushtet minimale lidhur me sistemin e shpërndarjes së ajrit dhe sistemin ftohës. Ftohja e dhomës realizohet me anë të kondicionerit të thjeshtë;
- e. Dhoma e serverëve nuk plotëson kushtet teknike lidhur me kapacitetin dhe cilësinë dhe planit të emergjencës sa i përket sistemit elektrik;
- f. Në dhomën e serverëve mungon sistemi i alarmit dhe hyrja në dhomë nuk është e siguruar me anë të një sistemi elektronik dhe sistem alarmi në rast thyerje të saj; në kundërshtim me pikën 4.1, 4.3, 4.4, 4.5 dhe 4.6 të Rregullores për ndërtimin e dhomës së serverëve.
- g. Nga auditimi i pajisjeve të cilat janë vendosur në dhomën e serverit rezultoi se rack-u i vendosur nuk është i mbrojtur kundër lëkundjeve sizmike, nuk ka hapësirë përpara apo anash tij sipas përcaktimeve të prodhuesit, në kundërshtim me pikën 4.2 të Rregullores për ndërtimin e dhomës së serverëve.
- h. Nga auditimi i procedurës së administrimit të dhomës së serverëve konstatohet se në kundërshtim me pikën 6 të Rregullores për ndërtimin e dhomës së serverëve hyrja dhe dalja në dhomën e serverëve nuk është e rregulluar me një procedurë të miratuar duke kompromentuar sigurinë e saj me hyrje-dalje të personave të paautorizuar. Nuk ka një procedurë të shkruar në rast të marrjes në përdorim të çelësit të dhomës së serverëve nga stafi i TI-së dhe ruajtjes së tij në rastet e emergjencës.

- i. Konstatohet se në dhomën e serverëve ruhen dhe administrohen edhe materiale të tjera (dosje, dollap, karrige) të cilat rrisin riskun e dëmtimeve të saj.
- j. Nga auditimi u konstatua mungesa e kamerave të sigurisë në dhomën e serverëve për monitorimin e hyrje-daljeve dhe veprimtarisë brenda në sallë. Hyrja dhe dalja në dhomën e serverëve monitorohet vetëm nga kamerat e korridoreve të institucionit.

Foto nga ambienti fizik i dhomës së serverëve ku janë të vendosur rack dhe serverat e bibliotekës dixhitale




Auditimi mbi pajisjet router dhe infrastruktura e networkut

Referuar pikave kryesore të sigurisë së informacionit në rrjetin privat dhe publik janë verifikuar onsite infrastruktura network e institucionit. Komunikimi me fakultetet, realizohet me fibër optike. UV ka ngritur një infrastrukturë të zgjeruar network në qendër e në fakultete.

Topologjia e infrastrukturës së ndërtuar Hardware/Software/Network:

Topologjia e networkut është standard industry network, përbëhet nga kompjutera për përdorim personal dhe rrjeti i brendshëm kompjuterik, nëpërmjet të cilit aksesohet interneti dhe printerat e institucionit. Me anë të këtij rrjeti aksesohen shërbimet e tjera On-Line që ofrohen për UV dhe paraqitet si më poshtë:



Nga auditimi u konstatua:

Shërbimet që ofron teknologjia e informacionit në UV mbështeten në një infrastrukturë IT jo të konsoliduar dhe në disa pjesë është e amortizuar. Shërbimet e ngritura mbi këtë rrjet nuk janë të sigurta dhe nuk mbështesin vazhdimësinë e punës dhe perspektivën e zhvillimeve të përcaktuara.

1.Titulli i gjetjes: Siguria e rrjetit të UV është e kompromentuar pasi nuk ka Active Directory dhe Domain Controller për një identifikim të qendërzuar dhe sigurt.

Situata: Nga auditimi u konstatua se UV, nuk ka ngritur Active Directory për menaxhimin e userave, pajisjeve, aplikacioneve dhe marrjen e shërbimeve me anë të një autentifikimi të vetëm “single sign in” për një identifikim të qendërzuar të sigurt të kontrollit dhe menaxhimin e shërbimeve në përputhje me standardet me të mira.

Kriteri: Politikat e sigurisë së informacionit mbulojnë të gjithë risqet operacionale dhe ka mundësi të mbrojnë në mënyrë të arsyeshme të gjithë asetet e informacioneve kritike kundrejt humbjeve, dëmtimit dhe abuzimit.

Politikat e sigurisë së informacionit janë të afta të mbrojnë të gjithë informacionin konfidencial lidhur me palët e brendshme dhe të jashtme detyra dhe përgjegjësi të qarta të IT lidhur me Politikën e Sigurisë së Informacionit (referuar ISO 27000).

Ndikimi/Efekti : Risk i mos përmbushjes së veprimtarisë institucionale, humbje të informacionit.

Shkaku: Mos zbatim praktikave më të mira (Ref. ISO 27000 Sistemi i menaxhimit të sigurisë së informacionit).

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Strukturat drejtuese në Universitetin e Vlorës në bashkëpunim me sektorin e IT-së të marrë masa për planifikimin dhe ngritjen e një Active Directory me qëllim standardizimin e infrastrukturës IT, rritjen e

sigurisë së rrjetit si dhe garantimin e një identifikimi të qëndrueshëm dhe të sigurt.

2.Titulli i gjetjes:	Planet e vazhdimësisë së punës dhe procedurat e backup.
Situata:	Nga auditimi u konstatua se: - UV nuk disponon dokument të planeve të vazhdueshmërisë së punës (BCP) dhe një plan të rikuperimit nga katastrofa (disaster recovery) me qëllim garantimin e vazhdueshmërisë së ofrimit të shërbimeve në raste të jashtëzakonshme emergjencash në kundërshtim me pikën 1 shkronja c) dhe ç), të VKM nr. 710, datë 21.08.2013, i ndryshuar. -Për procedurat e back up, UV nuk ka të dokumentuar ndonjë dokument administrativ si Rregullore e Brendshme apo dokument tjetër TIK ku të përcaktohet mënyra e kryerjes së backup-ve.
Kriteri:	VKM nr. 710, datë 21.08.2013, i ndryshuar, dhe praktikën më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare (<i>COBIT dhe Manuali i Auditimit IT</i>).
Ndikimi/efekti:	Humbje e të dhënave dhe risk për vazhdimësinë e punës dhe ndërprerjes së shërbimeve.
Shkaku:	Mos zbatim i standardeve të sigurisë mbi ruajtjen dhe përpunimin e informacionit
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Strukturat drejtuese në Universitetin e Vlorës në bashkëpunim me sektorin e IT-së të marrin masa për ndërtimin dhe hartimin e planeve të vazhdimësisë së biznesit duke përfshirë planet për backup për sistemet, pajisjet kompjuterike dhe të dhënat, me qëllim garantimin e sigurisë së informacionit dhe uljen e riskut për ndërprerjen e shërbimeve dhe vazhdimësisë së punës.

3.Titulli i gjetjes:	Mungesa e monitorimit të hyrje - daljeve me anë të sistemeve elektronike, në ambientet fizike të Rektoratit
Situata:	Nga auditimi u konstatua se në hyrjen kryesore të Rektoratit të UV është instaluar një sistem i veçantë aksesit për hyrje daljet e punonjësve të UV por ky sistem nuk është funksional dhe nuk përdoret për të monitoruar hyrje-daljet, duke kompromentuar nivelin e sigurisë së aksesit në ambientet e saj me qëllim kufizimin e aksesit fizik të personave të paautorizuar.
Kriteri:	Sigurimi se masat organizative dhe fizike garantojnë parandalimin e aksesit të paautorizuar.
Ndikim/Efekti:	Risk për akses të pa autorizuar.
Shkaku:	Nuk janë marrë masat e nevojshme administrative për akses të sigurt duke mos zbatuar praktikën më të mira.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	Strukturat drejtuese në Universitetin e Vlorës në bashkëpunim me sektorin e IT-së marrin masa për të analizuar nivelin e sigurisë së aksesit në ambientet e rektoratit me qëllim kufizimin e aksesit të personave të paautorizuar që nuk janë pjesë e administratës por edhe për të administruar hyrje daljet e stafit të administratës së rektoratit si dhe të marri masa për vendosjen në funksion të sistemit të aksesit që ka të instaluar në godinën e rektoratit

- 4.Titulli i gjetjes:** Mos menaxhim i incidenteve dhe ndryshimeve, dhe mungesa e plan veprimit për minimizimin e risqeve.
- Situata:** Për periudhën e audituar, u konstatua se Universiteti i Vlorës nuk ka politika të ruajtjes së dokumenteve dhe nuk ka të dokumentuar një plan masash për identifikimin, trajtimin e gabimeve dhe incidenteve që mund të ndodhin në infrastrukturën IT, dhe në mungesë të procedurave të shkruara, risqet menaxhohen mbi bazë ngjarjesh. Suporti, mbështetje teknike dhe logjike për operacionet IT që ndihmojnë mbarëvajtjen e strukturave të institucionit, kryhen nëpërmjet shkëmbimeve verbale dhe nëpërmjet e-mail-eve.
- Ndikimi/efekti:** Mos realizim i objektivave, shkelje të sigurisë, humbje të të dhënave.
- Shkaku:** Mos zbatim i ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”.
- Rëndësia:** E lartë
- Rekomandimi:** Strukturat Drejtuese në Universitetin e Vlorës në bashkëpunim me sektorin TIK të marrin masa për identifikimin, dokumentimin dhe monitorimin e incidenteve si dhe menaxhimin e ndryshimeve dhe dokumentimin e tyre.
- 5.Titulli i gjetjes:** Dhoma e serverave dhe infrastruktura network nuk plotësojnë standardet e përcaktuara dhe mbështeten në një infrastrukturë IT (rrjeti network) të amortizuar.
- Situata:** -Nga auditimi u konstatua se ambienti fizik i dhomës së serverëve ku është hostuar sistemi i bibliotekës dixhitale në Universitetin e Vlorës nuk është në përputhje me standardet e përcaktuara në rregulloren për ndërtimin e dhomës së serverëve të miratuar nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit.
-Shërbimet që ofron teknologjia e informacionit në UV mbështeten në një infrastrukturë IT jo të konsoliduar dhe në disa pjesë është e amortizuar. Shërbimet e ngritura mbi këtë rrjet nuk janë të sigurta dhe nuk mbështesin vazhdimësinë e punës dhe perspektiven e zhvillimeve të përcaktuara.
- Kriteri:** Garantimi i sigurisë fizike dhe ambientale është në përputhje me kërkesat për siguri dhe me klasifikimin e sensitivitetit të aseteve IT. Garantimi se ndërhyrjet zbulohen dhe trajtohen (Politika të brendshme të sigurisë). Rregulloren e miratuar nga AKSHI “Për ndërtimin e dhomës së serverëve” (versioni 1.0, datë 02.12.2008
- Ndikimi/efekti:** Cënim i sigurisë, hyrje e paautorizuara dhe risk humbje të të dhënave
- Shkaku:** Mungesa e investime në infrastrukturë dhe mos zbatim i praktikave më të mira në ngritjen dhe menaxhimin e infrastrukturës network.
- Rëndësia:** E lartë
- Rekomandimi:** Strukturat drejtuese në Universitetin e Vlorës në bashkëpunim me sektorin e IT-së marrin masa për planifikimin dhe ngritjen e një infrastrukturë IT (ambienteve të dhomës të serverëve dhe rrjetin network) në përputhje me kushtet teknike të përcaktuara në

rregulloren e miratuar nga AKSHI, që parashikon përcaktimin e standardeve të TIK si dhe në përputhje me udhëzimet, standardet dhe praktikat më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare.

4. Auditimi i sistemeve

a. Verifikimi i kontrolleve të aplikacioneve për të dhënat Input/Output

Nga auditimi u konstatua se për periudhën objekt auditimi Universiteti i Vlorës ka pasur dhe ka në përdorim sistemet si më poshtë:

Për periudhën objekt auditimi Universiteti i Vlorës ka në përdorim 3 sisteme të cilët janë:

- *Sistemi UVMS*. Ky aplikacion është implementuar në vitin 2017 është funksional dhe aktualisht në përdorim, në mbështetje të Planit Strategjik të UV për funksionimin si Universitet SMART, duke u fokusuar në shfrytëzimin me efektivitet të teknologjisë së komunikimit dhe informacionit në sistemin e menaxhimit dhe organizimit të universitetit. UVMS i ndihmon studentët të ndjekin progresin e tyre akademik qysh prej fillimit të studimeve deri në diplomim. Aty ata kanë informacion mbi librezën e tyre sipas programit akademik që ata ndjekin, njëkohësisht mund të aksesojnë dhe ecurinë e tyre akademike nëpërmjet modulit të transkriptit.

– *Biblioteka Dixhitale*. është krijuar si rrjedhojë e kriterëve të vendosura nga grupi i akreditimit, dhe marrëveshjes për paktin me studentët. Ruajtja e fondeve arkivore dhe mundësi i shfletimit në format elektronik shërben për:

- Të mënjanuar humbjen e parikuperueshme dhe shmangur kontaktin direkt me materialet fizike të konsumuara nga përdorimi dhe koha; Për të lehtësuar shfletimin në funksion të zhvillimit akademik;
- Të ruajtur trashëgiminë kulturore kombëtare;
- Të rritur promovimin e dijeve dhe kulturës në rrafshin ndërkombëtar, duke marrë pjesë në shkëmbimin e ndërsjelle të njohurive dhe vlerave, në shërbim zhvillimit të qytetërimit.

– *Alpha web*. Nëpërmjet tij kryhet administrimi i dokumentacionit dhe veprimeve kontabël, që nga struktura e llogarive, përmbajtja dhe cilësitë e kartelave të llogarive, fletët kontabël, librat dhe dritaret e regjistrimeve të tyre. Në Alpha Web, mënyra se si kontabilizohet një dokument mundëson administrim financiar shumë më të pasur dhe komod.

Nga auditimi i sistemeve të cilat u vlerësuan si më të rëndësishme:

I. Sistemi UVMS ose sistemi për studentët shërben për menaxhimin dhe organizimin e procesit dhe kontrollit të mësimdhënies si dhe procesin e pranimit, regjistrimit dhe ofrimit të shërbimeve për studentët. Kjo platformë i shërben stafit akademik, studentëve dhe zyrës së njësisë së cilësisë. Ndërveprime apo shkëmbime të dhënash me aplikacione të tjera nuk janë ndërtuar.

Senati Akademik me vendimin nr.101, datë 06.12.2017, protokolluar me nr.1576/5, datë 01.12.2017, publikuar dhe në faqen web të universitetit: <https://univlora.edu.al/wp-content/uploads/2018/09/vendim-Senati-101.pdf>, ka urdhëruar vënien në punë të platformës digjitale “Sistemi i Menaxhimit të informacionit mësimor të UV” me akronimin UVMS – University of Vlora Management System,

Ky aplikacion është ndërtuar si një kontribut nga përgjegjësi i Sektorit TIK zhvilluar mbi burime të hapura të kodimit (open source), për të cilin Universiteti i Vlorës nuk ka paguar asnjë kosto zhvillimi. Paga që UV kryen për hostimin në Cloud është 960 euro në vit për të gjitha shërbimet që janë: hostimi i sistemit UVMS, Email-et, Faqja Web etj.

Sistemi UVMS edhe pse përdoret për menaxhimin dhe organizimin e procesit dhe kontrollit të mësimdhënies si dhe procesin e pranimit, regjistrimit dhe ofrimit të shërbimeve për studentët,

dokumentet që gjenerohen prej tij nuk janë zyrtare pasi sistemi nuk është i licencuar për përdorim dhe nuk është në pronësi të Universitetit të Vlorës.

Platforma UVMS është një sistem modular i cili operon mbi bazën e moduleve të ndryshme, duke mundësuar shërbimet e nevojshme për çdo grup përdoruesish. Secili përdorues pajiset me një kod llogarie dhe një fjalëkalim fillestar, më pas secili përdorues e menaxhon në mënyrë të pavarur llogarinë e tij. Secili grup përdoruesish është i autorizuar ta përdorë në mënyrë të përgjegjshme sistemin, çdo input dhe veprim i paligjshëm dhe në kundërshtim me rregulloren e UV është i dënueshëm me ligj. Çdo input informacioni në sistem shoqërohet me shkresë përkatëse sipas procedurave të UV të përcaktuara në rregulloren e UV.

Të dhënat që bëhen Input në këtë sistem janë:

- Krijimi i programeve akademike ngarkohen në sistem nga IT e fakulteteve përkatëse;
- Krijimi i profileve të studenteve me të dhënat përkatëse nga sekretari;
- Ngarkimi i kurikulës për çdo student me të dhënat të programeve akademike regjistruar më parë;
- Krijimi i lëndëve të mbartura;
- Hedhja e vlerësimeve.

Për çdo veprim input të gjithë përdoruesit bëjnë konfirmimin me kodin e sigurisë, opsion i cili ofron një siguri të lartë në hedhjen e të dhënave.

Autorizimet e të dhënave:

Secili përdorues kontrollon të dhënat e veta dhe asnjë përdorues tjetër nuk mund të kontrollojë të dhënat e populluara nga një përdorues tjetër.

Kurrikula hidhet në fillim të vitit bashkë me kreditet përkatëse të secilës lëndë atëherë këto të dhëna hidhen automatikisht nga sistemi kur pedagogu do të popullojë notën e studentit.

Rekordet e plotësuara nga sekretaret mund të anulohen dhe të ri hidhen nga e para, ndërsa rekordet e plotësuara prej pedagogëve që janë në statusin draft, pra pa u konfirmuar mund të përditësohen deri në konfirmim. Në momentin që është iniciuar një proces dhe kërkohen të dhënat për plotësimin e tij, përdoruesi nuk mund të lë bosh fusha të caktuara që janë konfiguruar si të detyrueshme.

Ndryshimet e të dhënave mund të bëhen nga vetë përdoruesi dhe askush tjetër. Autorizim të veprimeve nëpërmjet sistemit nuk ka, secili kontrollon veprimet e veta.

Të gjitha të dhënat mund të ndryshohen nëse ato janë në fazat ku ndryshimet lejohen të kryhen.

Megjithëse workflow të proceseve të punës nuk janë ndërtuar, bazuar në intervistën e zhvilluar me përgjegjës të sektorit TIK, si dhe në përgjigjet e pyetësorit mbi sistemet, proceset në sistemin UVMS ndjekin këto hapa:

Fillimisht informacionet iniciohen nga sektori/drejtoria/departamenti përkatës dhe përcillen pranë autoriteteve drejtuese të institucionit për kontrollet e nevojshme. Nëse marrim në konsideratë krijimin e orarit për klasat dhe leksionet që studentët duhet të ndjekin në një semestër të caktuar, fillimisht informacioni krijohet dhe përpunohet në departamentin përkatës, më pas ky informacion dërgohet në formë shkresore në Drejtorinë e Komunikimit dhe Burimeve Njerëzore, e cila ja përcjell Sektorit IT për implementim në platformën UVMS. Pas hedhjes së informacionit në platformën UVMS, i bëhet e disponueshme në formatin elektronik përdoruesve bazuar në rolin e tyre përkatës. Platforma UVMS gjeneron informacion të personalizuar sipas kërkesës së përdoruesit në format tekst.

Për çdo veprim të përdoruesve ruhen data log-s mbi ndryshimet se si ishte e dhëna dhe si u ndryshua. Stafi i IT në UV kryen monitorimin dhe analizimin e të dhënave mbi veprimet e përdoruesve përmendur më sipër dhe vlerëson problematikat si dhe marrjen e masave përkatëse të bllokimeve të aksesit në IP specifike apo grupe të caktuara.

Nga auditimi u konstatua se:

- Mungojnë akte rregullatorë të brendshëm për menaxhimin e log-eve të përdoruesve.
- Nuk ka manual administrimi pasi sistemi është ndërtuar dhe parametrizuar nga administratori që është përgjegjësi i sektorit IT në UV.
- Nuk janë ndërtuar në mënyrë skematike Workflow për proceset e punës që ndjekin në sistem stafi akademik, administrativ si dhe studentet.

Platforma UVMS gjeneron informacion të personalizuar sipas kërkesës së përdoruesit në format tekst.

Output i të dhënave në trajtë raportesh që gjenerohen nga sistemi janë:

- Vërtetime të ndryshme që printon kryesekretar-ja;
- Lista e notave;
- Raporte me të dhënat e anketimeve;

Pavarësisht rolit të përdorimit, çdo përdorues mund të editoj, përditësoj vetëm ato informacione që ka populluar vetë si përdorues.

UV e përfaqësuar nga rektori, *ka nënshkruar krijimin e Rrjetit Akademik Shqiptar - RASH dhe me anë të shkresës nr. 1411 prot, datë 10.11.2017, ka vendosur të jetë pjesë e marrëveshjes me nr.88, datë 14.02.2018 për “Krijimin e Qendrës Ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik Shqiptar”.*

Konform pikës 3/ç dhe 4/a, qëllimi i RASH:

- 3/ç: Është zhvillimi i programeve software dhe ofrimi i shërbimeve përkatëse për ministrinë përgjegjëse për arsimin, agjencitë e varësisë për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, institucionet e arsimit të lartë, të kërkimit shkencor dhe inovacionit e për të gjithë anëtarësinë e RASH-it, si dhe për palë të treta.

- 4/a: Kryen zhvillimin dhe ofrimin e sistemeve më të përparuara software për administrimin e procesit të aplikimit universitar, menaxhimin e proceseve akademiko-shkencore dhe administrative-universitare dhe platformave për formimin dhe testimin on-line për arsimin e lartë, në kuadër të rritjes së cilësisë në arsim dhe pjesëmarrjes në aktivitetet e kërkimit dhe të zhvillimit, të drejtuara nga komuniteti shkencor dhe arsimor ndërkombëtar.

Pra, megjithëse RASH ka detyrimin të ofrojë sistemeve të përparuara software për administrimin e procesit të aplikimit universitar, Senati Akademik i UV me vendimin nr.101, datë 06.12.2017, ka urdhëruar vënien në punë të platformës digjitale “Sistemi i Menaxhimit të informacionit mësimor të UV” me akronimin UVMS – University of Vlora Management System, që është zgjidhja e ofruar nga specialistët IT në UV.

II. Biblioteka Dixhitale, implementuar në vitin 2020 – 2021 është krijuar si rrjedhojë e kriterëve të vendosura nga grupi i akreditimit, dhe marrëveshjes së bërë për paktin me studentët.

Nëpërmjet dixhitalizimit të botimeve që ndodhen në bibliotekën e Universitetit të Vlorës, do të sigurohet konvertimi dhe ruajtja në dokument elektronik e informacionit libër. Biblioteka dixhitale do të shërbejë stafit akademik, studentëve por dhe stafit administrativ. Sistemi i Bibliotekës dixhitale nuk ndër vepron me sisteme të tjera.

Nga auditimi mbi të dhënat e skanuara u konstatua se, që prej nënshkrimit të kontratës me nr. 957/23, datë 24.09.2020 e deri më sot janë kryer afërsisht 8000 faqe skanime të cilat janë nga: I. Fondi "Materialet e rralla, dorëshkrimet e Lefter Çipës, ku përfshihen 17 lidhje të mëvetësishme dhe në version original të autorit;

1. Këngët e Atdheut tim, vëllimi 1 (dok. i lidhur) - 1 copë;
2. Këngët e Atdheut tim, vëllimi. 2, dok i lidhur) - 1 copë;
3. Këngët e Atdheut tim, vëllimi 3 (dok. i lidhur) - 1 copë;
4. Këngët e Atdheut tim, vëllimi ll. 4 (dok. i lidhur) - 1 copë;
5. Këngët e Atdheut tim, vëllimi. 5 (dok. i lidhur) - 1 copë;
6. Tekste autoriale të ansambleve të këngës qytetare - 1 copë;
7. Tekste të këngëtarëve të muzikës popullore e qytetare - 1 copë;

8. Poezi tipologjike lidhje të mëvetësishme (version origjinal) - 17 copë;
 9. Monografi jetën, veprën dhe historinë e Grupit të Pilurit - 1 copë;
 10. Monografi për Polifoninë e famshme në trevat e Himarës - 2 copë;
 11. Hulumtime të poezisë orale, mbledhur e regjistruar nga autori - 10 copë;
 12. Dorëshkrime të lidhura në vëllime me shkrim e firma origjinale (40 copë);
- II. Kanë përfunduar kopjet unikalë të Fondit Albanologjik:
1. Francesco Altimari;
 2. Matteo Mandala;
 3. Kopja e vetme që disponon biblioteka universitare e Vlorës nga poema "Mbreti ynë" e autorit Ali Asllani, 1935;
 4. "Gjahu i Malësorëvet/ Hieja e Tomorrit" në të dy krye dialektet e Kostandin Kristoforidhit, tekst unikal, shkruar më 1884.

Grupi i auditimit verifikoi një rast të skanimit për të parë nga afër se si veprohet me skanimin dhe ruajtjen e tij.

Afati për përfundimin e dixhitalizimit nuk rezulton të jetë vendosur nga Senati. Ky është një proces i vijueshëm digjitalizimi sepse janë në përditësim të vijueshëm njësitë libra dhe jo libra ku bëjnë pjesë: literatura, tekstet libra, buletine, revista shkencore, artikuj shkencorë, harta, disertacione, fonoteka etj.

Nga auditimi u konstatua se:

- Dixhitalizimi i arkivës është i ngadaltë dhe do të vazhdojë po në të njëjtën situatë nisur nga fakti se në këtë proces janë angazhuar vetëm dy punonjësit e bibliotekës.
- Ky sistem nuk aksesohet ende nga studentët pasi është në fazën e popullimit të të dhënave dixhitale. Aktualisht në këtë sistem punojnë vetëm dy punonjësit e bibliotekës të cilët janë dhe punonjësit e ngarkuar për dixhitalizimin.
- Me hapat që po ecën procesi i popullimit në bibliotekën dixhitale, nuk do të jetë gati për shumë vjet, çfarë sjell jo vetëm një amortizim të pajisjeve, por një risk shumë i lartë se materialet e skanuara pas shumë vitesh nuk do t'i shërbejnë më studimeve universitare. Qëllimi i këtij investimi kundrejt studentëve dhe stafit akademik të universitetit mund të mos arrihet.

1.Titulli i gjetjes:	Universiteti i Vlorës nuk ka vënë në përdorim sistemin Pitagora ofruar nga RASH.
Situata:	Nga auditimi u konstatua se Universiteti i Vlorës, nuk ka vënë në përdorim sistemin Pitagora ofruar nga RASH, megjithëse vet ky universitet ka nënshkruar dhe është bërë pjesë e marrëveshjes së bashkëpunimit me Rrjetit Akademik Shqiptar.
Kriteri:	Pikat 3/ç dhe 4/a të VKM nr. 88, datë 14.02.2018 për "Krijimin e Qendrës Ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik Shqiptar".
Ndikimi/efekti:	Mungesë të dhënash në sistemin Pitagora, një sistem i përmirësuar për t'i shërbyer studentëve sipas marrëveshjes që vetë universitetet kanë nënshkruar.
Shkaku:	Mungesë angazhimi për të identifikuar, dokumentuar dhe raportuar mangësitë dhe nxituri zgjidhjet që vënë në funksion marrëveshjen.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Universiteti i Vlorës, të analizojë, të identifikojë dhe të dokumentojë të gjitha arsyet teknike, financiare dhe ligjore për të cilat nuk kanë vënë në përdorim sistemin Pitagora ofruar nga Rrjeti Akademik Shqiptar, si një detyrim që rrjedh nga marrëveshja e nënshkruar ndërmjet universiteteve dhe RASH.

Rekomandimi:	Universiteti i Vlorës të adresojë në institucionet përgjegjëse që janë Ministria e Arsimit dhe RASH, çështjet që e kanë penguar të vërë në funksion sistemin Pitagora, në mënyrë që të nxiten të gjithë faktorët për qartësimin dhe saktësimin njëherë e mirë mbi të drejtën e zhvillimit të sistemeve informatike që ndërtohen në shërbim të studentëve në mënyrë që të parandalohen investime me qëllime të njëjta.
2.Titulli i gjetjes:	Nuk janë hartuar të gjitha aktet rregulluese/udhëzuese për sistemin UVMS.
Situata:	Nga auditimi mbi dokumentacionin e hartuar mbi sistemin UVMS, u konstatua se: -Mungon një akt rregullatorë të brendshëm për menaxhimin e log-eve të përdoruesve. -Nuk ka manuale për administrimin e sistemit UVMS. -Nuk janë ndërtuar në mënyrë skematike Workflow për proceset e punës që ndjekin në sistem stafi akademik, administrativ si dhe studentët.
Kriteri:	Gjurma e auditimit
Ndikimi/efekti:	Paqartësi në mënyrën se si sistemi funksionon si dhe kush duhet të veprojë.
Shkaku:	Angazhimet në kohë reale me mbarëvajtjen e sistemit.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	Universiteti i Vlorës, të marrë masa për hartimin dhe miratimin e dokumentacionit që mungon si workflow, manuali i administrimit si dhe mënyra se si do të administrohen log-et e përdoruesve, si dokumentacion i nevojshëm për gjurmën e auditimit në sistemin UVMS.
3.Titulli i gjetjes:	Popullimi në sistemin e arkivës dixhitale po kryhet me ritme shumë të ngadalta.
Situata:	Nga auditimi të dhënat e regjistruara në arkivën dixhitale, u konstatua se: - Dixhitalizimi i arkivës është i ngadaltë dhe do të vazhdojë po në të njëjtën situatë nisur nga fakti se në këtë proces janë angazhuar vetëm dy punonjësit e bibliotekës. - Ky sistem nuk aksesohet ende nga studentët pasi është në fazën e popullimit të të dhënave dixhitale. Aktualisht në këtë sistem punojnë vetëm dy punonjësit e bibliotekës të cilët janë dhe punonjësit e ngarkuar për dixhitalizimin. - Me hapat që po ecën procesi i popullimit në bibliotekën dixhitale, nuk do të jetë gati për shumë vjet, çfarë sjell jo vetëm një amortizim të pajisjeve, por një risk shumë i lartë se materialet e skanuara pas shumë vitesh nuk do t'i shërbejnë më studimeve universitare. Qëllimi i këtij investimi kundrejt studentëve dhe stafit akademik të universitetit rrezikon të mos arrihet.
Kriteri:	Objektivi dhe qëllimi i investimit.
Ndikimi/efekti	: Ritmi i ngadaltë i dixhitalimit pengon arritjen e objektivave të këtij investimi si dhe rrezikon mos t'ju shërbejë studentëve të këtij universiteti por jo vetëm.

Shkaku:	Mungesë e burimeve njerëzore që nevojiten për t'u angazhuar me këtë proces.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi 1 :	Universiteti i Vlorës, të marrë masa për përcaktimin e afatit maksimal të dixhitalizimit të materialeve aktuale që ndodhen në bibliotekën e universitetit dhe që i shërbejnë programeve studimore universitare.
Rekomandimi 2:	Universiteti i Vlorës, të marrë masa për sigurimin e burimeve njerëzore të përkohshme, të nevojshme për të përmbushur afatin maksimal të dixhitalizimit të bibliotekës së këtij universiteti, çfarë do të garantojë vënien në punë në një kohë të shpejtë dhe përmbushjen e qëllimit të këtij investimi informatik, duke ju ofruar studentëve materialet e nevojshme për çdo program studimi në kohë reale.

b. Kontrolli i shkallës së sigurisë së aplikacioneve, të drejtat e përdoruesve dhe menaxhimi i tyre

Universiteti i Vlorës ka miratuar me vendim Senati Akademik nr. 64, datë 20.12.2019 rregulloren për përpunimin ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, publikuar dhe në faqen web: <https://univlora.edu.al/rregullore-per-mbrojtjen-perpunimin-ruajtjen-dhe-sigurine-e-te-dhenave-personale/>.

Aplikacionet janë të pajisura me modul user activity i cili bën të mundur gjurmimin e aktivitetit të përdoruesit. Serverat kanë “log modules” të implementuar të cilët ruhen për aq kohë sa e lejon konfigurimi standard i tij. Ndërsa aktiviteti i përdoruesit ruhet për një vit akademik vendosur kjo me mirëkuptim, për shkak të hapësirës.

Identifikimi në sistemin UVMS për çdo përdorues kryhet me fjalëkalim, kompleksiteti i të cilit është konfiguruar vetëm në gjatësi karakteresh, minimumi 8.

Krahas identifikimit me fjalëkalim, çdo përdorues krijon një numër unik, të cilët i kërkohen sa herë që ai kryen një veprim. Ky parametrizim u gjend vetëm në sistemin UVMS të UV, konfigurim i cili ka rritur sigurinë e veprimeve që kryhen. Nëpërmjet kësaj mënyre sigurohet përdoruesi se kudo ku mund të ketë ruajtur fjalëkalimin për hyrjen e shpejtë të llogarisë (remember password), veprime në emër të tij nuk mund të kryhen.

Nga auditimi u konstatua se UV nuk disponon rregullore mbi administrimin e përdoruesve që aksesojnë sistemet: UVMS dhe Biblioteka Dixhitale.

Përdoruesit e Sistemit UVMS. Në këtë sistem janë afërsisht 360 përdorues. Në këtë numër përdoruesish bëjnë pjesë punonjës të UT të ndara sipas roleve si më poshtë:

- Uvadmin - Krijon profile për këta grup përdoruesish, sekretare, pedagog, kryesekretare, zyra e cilësisë, zyra e studentit, zyra e financës (1 përdorues);
- Sekretaret menaxhojnë profilin e studentëve, historikun akademik si programin akademik dhe lëndët që duhet të ndjek në çdo sezon mësimdhënie (13 përdorues);
- Grup përdorues Pedagog aksesojnë sistemin për orarin e leksioneve seminareve, komunikojnë me studentët, dërgojnë leksione në format pdf, vendosin vlerësimet e detyrave provimeve të pjesshme (322 përdorues);
- Grup përdorues kryesekretare, printojnë vërtetim studentësh, vërtetim notash, dhe lista notash (4 përdorues);
- Shef Departamenti hedh të dhënat e programeve akademike përkatësisht, dhe krijimin e orareve për seminare dhe leksione (14 përdorues);
- Mbledh të dhënat e anketimeve dhe grupon në tabela sipas degëve (1 përdorues);
- Printon mandat pagesat, dhe vendos tarifatat e studimit për studentët (4 përdorues);

- Shikon pagesat e hedhura nga zyra e studentit sipas degëve përkatëse (1 përdorues).

Çdo input informacioni në sistem shoqërohet me shkresat përkatëse sipas procedurave të përcaktuara në rregulloren e UV. Pavarësisht rolit të përdorimit, çdo përdorues mund të editoj, përditësoj vetëm ato informacione që ka populluar vetë si përdorues.

Për krijimin e llogarisë dhe pajisjen me kredencialet e aksesimit përdoruesit në rolin e studentit bëjnë kërkesë në sekretaritë e departamenteve përkatëse dhe nëse ata janë studentë të UV u krijohet llogaria dhe pajisen me kredencialet e aksesimit.

UVMS ka këta grup përdoruesish: Studentë, Pedagog, Sekretare, Staf, Administrator. Nuk ka fshirje të përdoruesve por ç'aktivizim ose përditësim të llogarive të tyre. Sekretaret e departamenteve përkatëse menaxhojnë informacionin e grup përdoruesve studentë, ato mund të përditësojnë informacionin e tyre si fjalëkalimet etj. Fillimisht studenti paraqitet te sekretaria e departamentit përkatës me një dokument identifikimi dhe më pas ajo bën përditësimin e të dhënave përkatëse.

4.Titulli i gjetjes:	Mungojnë akte rregullative dhe mungesë standartizimi tek përdoruesit.
Situata:	Nga auditimi mbi të dhënat e përdoruesve të hapur në sistemin UVMS u konstatua se, UV për periudhën nën auditim nuk disponon një akt rregullative, për administrimin e përdoruesve në të cilin të përcaktohen procedurat që do të ndiqen për administrimin e përdoruesve.
Situata:	Nga verifikimi në nivel administrativ që grupi i auditimit kreu në sistem lidhur me krijimin, ndryshimin dhe mbylljen e përdoruesit, rezultoi se: Nuk është ndjekur i njëjti standard në krijimin e përdoruesit: - Në një rast është krijuar sipas modelit emërmbiemër; - Në disa raste janë krijuar sipas modelit emër.mbiemër; - Në disa raste sipas modelit emër.
Situata:	Ka përdorues me kredenciale të përgjithshme: - 4 përdorues me emër zyra4, zyra1, zyra2, zyra3 - 15 përdorues me emër menaxhofshp, depinfirmieri, depekonomiks, depfinance, menaxhofsht, menaxhofe, menaxhofi, menaxhofshh, depbiznesi, menaxhoft etj.
Kriteri:	
Ndikimi/efekti:	Risk të lartë për ndërhyrje të paautorizuara në sistem pasi nuk identifikohet saktësisht përdoruesi që ka kryer një aktivitet të caktuar.
Shkaku:	Mungesa e akteve rregullative si dhe një standardi të miratuar për përdoruesit.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Universiteti i Vlorës të marri masa për të identifikuar dhe miratuar një standard dhe akt rregullativë mbi menaxhimin e përdoruesve si një mjet i domosdoshëm i cili garanton gjurmën e veprimeve të përdoruesve dhe ofron një identifikim më të sigurt në sistemet informatike..
Rekomandimi:	Sektori i IT në Universitetin e Vlorës të marri masa që në bazë të rregullores së miratuar për përdoruesit dhe standardit të aprovuar për identifikimin e përdoruesit, të bëjë korrigjimet e nevojshme në emërtimin me saktësi të përdoruesit kur këto emërtime janë vendosur me shkurtime, emra departamentesh apo emra zyre.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

A. MASA ORGANIZATIVE:

1.Titulli i gjetjes: auditimi u konstatua se, specialistët e Sektorit IT të cilët janë pjesë e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, janë të caktuar për të kryer detyra funksionale IT në secilin nga fakultetet e Vlorës, por për këtë shpërndarje të tyre nuk ka një Urdhër të brendshëm nga Rektorati. Gjithashtu, bazuar në strukturën e miratuar ka rezultuar se në asnjë fakultet nuk ka një pozicion specifik të përcaktuar për specialistët mbi kryerjen e detyrave të teknologjisë së informacionit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqe 11-14 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1.Rekomandimi: Rektorati i Universitetit Vlorë duhet të marrë masa për nxjerrjen e një urdhri në të cilin të caktohen specialistët në fakultetet respektive si dhe të përcaktohen detyrat funksionale të secilit prej tyre.

Menjëherë

2.Titulli i gjetjes: Nga auditimi u konstatua se, për periudhën objekt auditimi u konstatua se Universiteti i Vlorës, nuk ka plan trajnimi vjetor për vitet 2020 - 2021 për burimet njerëzore si dhe nuk ka zhvilluar trajnime për sektorin IT, personelin akademik mbi sistemet, sigurinë dhe teknologjinë e informacionit. Trajnimin e stafit akademik dhe administrativ për të rritur aftësitë e tyre në menaxhimin e sistemeve informatike të UV e kryen përgjegjësi i sektorit të Sektorit. Gjithashtu, specialistët e IT të këtij sektori atashuar pranë fakulteteve respektive janë përgjegjës për mbikëqyrjen dhe trajnimin e personelit akademik.

Nga auditimi u konstatua se, për periudhën objekt auditimi nuk janë zhvilluar trajnime mbi sistemet, sigurinë dhe teknologjinë e informacionit në kundërshtim me përshkrimin e punës miratuar me shkresën nr. Prot., 205/1 datë 14.02.2018.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqe 11-14 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1.Rekomandimi: Universiteti i Vlorës “Ismail Qemali” të marrë masa për identifikimin e nevojave për trajnimin e stafit i cili merret me administrimin e bazës së të dhënave dhe të çdo përdoruesi të sistemit, si dhe të hartojë e miratojë plane dhe politika për zhvillimin e trajnimeve në lidhje me sistemet, sigurinë dhe teknologjinë e informacionit.

Menjëherë dhe në vijimësi

3.Titulli i gjetjes: Nga auditimi u konstatua se, Universiteti i Vlorës nuk disponon regjistër rrishtu të përgjithshëm institucional, ku të përfshihen edhe rrishtet mbi IT dhe të mbulohen të gjithë aktivitetet duke përfshirë këtu rrishtet mbi sistemet, proceset e menaxhimit të ndryshimit, etj. Nuk ka identifikuar dhe vlerësuar ngjarjet e mundshme që mund të kenë efekt negativ përsa i përket arritjes së objektivave institucionale.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqe 11-14 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

3.1.Rekomandimi: Universiteti i Vlorës “Ismail Qemali” të marr masa për identifikimin dhe analizimin e risqeve për Teknologjinë e Informacionit me qëllim analizimin dhe vlerësimin e risqeve, për të mos riskuar përmbushjen e objektivave të institucionit në përputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar. Gjithashtu të marrin masa për hartimin dhe dokumentimin e një plani veprimi për minimizimin / parandalimin e risqeve të identifikuar, si dhe të bëhet monitorimi periodik i zbatimit të këtyre masave.

4.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të procedurës të prokurimit Krijimi i Datacenter dhe Ndërtimi i Sistemit të Integruar për menaxhimin e bibliotekës dixhitale

rezulton se disa prej kriterëve të veçanta për kualifikim janë të mbivendosura dhe të panevojshme për zbatimin e kontratës, konkretisht:

a) Të paktën 2 (dy) specialistë të certifikuar Technical Professional (ose ekuivalente sipas prodhuesit perkatës) për zgjidhjen hardëare të ofruar, me minimum 3 vjet eksperience profesionale.

b) Të paktën 1 (një) person të certifikuar PMP ose ekuivalent për menaxhimin e projekteve (Certifikimi duhet të jetë aktiv, i verifikueshem në listën e publikuar nga PMI ose ekuivalent, dhe me minimumi 5 vjet experience)

c) Të paktën 1 (një) specialist të certifikuar për SQL Database me minimumin 3 vjet eksperience profesionale.

d) Operatori Ekonomik duhet të ketë status Gold (ose ekuivalent) për pajisjet harduerë të ofruara. Ky kriter provohet nëpërmjet dokumentacionit të lëshuar nga prodhuesi perkatës në emër të operatorit Ekonomik ose nëpërmjet link të faqes web të prodhuesit ku vërtetohet ky status.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqe 14-28 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

4.1 Rekomandimi: Sektori i prokurimeve, grupet e hartimit të kriterëve për kualifikim, të marrin masa që në të ardhmen, në hartimin e Dokumenteve Standarde të procedurave të prokurimit, të shmangin vendosjen e kriterëve diskriminuesë për të krijuar kushtet e një konkurrence të lirë për pjesëmarrjen në tender të sa më shumë operatorëve ekonomik.

Menjëherë

5.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi dhe shqyrtimi i dokumentacionit të procedurës: “Implementimi i Datacenter dhe Sistemit të Integruar për menaxhimin e Bibliotekës u konstatua se në procesverbal nuk është evidentuar marrja në dorëzim e të gjitha mallrave.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqe 14-28 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

5.1 Rekomandimi: Titullari i autoriteti kontraktor të marrë masa që në vijimësi grupet e caktuara për marrjen në dorëzim të mallrave dhe ndjekjen e kontratave të dokumentojnë në procesverbal të gjitha mallrat e prokuruar.

Menjëherë

6.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi dhe shqyrtimi i dokumentacionit të procedurave të prokurimit me objekt Pagese Hostim Faqe” dhe Abonim Soft për Detektimin e Plagjiaturës rezultoi se nuk janë testuar çmimet e tregut për mallra e shërbime në përputhje me pikën 4 të Nenit 40 të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014, ‘Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik’.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqe 14-28 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

6.1 Rekomandimi: Universiteti Ismail Qemali të marrë masa që nga ana e grupeve të punës që do të ngrihen për procedurat e prokurimit që do të zhvillohen në të ardhmen në rastin kur procedura e prokurimit me vlerë të vogël zhvillohet në rrugë shkresore, anëtarët e komisionit të testojnë tregun për të marrë tregues për çmimet e punëve/mallrave/shërbimeve, të cilat i pasqyrojnë në një procesverbal të mbajtur dhe të nënshkruar nga komisioni.

Menjëherë

7.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se UV, nuk ka ngritur Active Directory për menaxhimin e userave, pajisjeve, aplikacioneve dhe marrjen e shërbimeve me anë të një autentifikimi të vetëm “single sign in” për një identifikim të qëndrueshëm të sigurt të kontrollit dhe menaxhimin e shërbimeve në përputhje me standardet me të mira.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 28-36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

7.1.Rekomandimi: Universiteti i Vlorës të marrë masa për planifikimin dhe ngritjen e një Active Directory me qëllim standardizimin e infrastrukturës IT, rritjen e sigurisë së rrjetit si dhe garantimin e një identifikimi të qëndrueshëm dhe të sigurt.

Në vijimësi

8.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se:

- UV nuk disponon dokument të planeve të vazhdueshmërisë së punës (BCP) dhe një plan të rikuperimit nga katastrofa (disaster recovery) me qëllim garantimin e vazhdueshmërisë së ofrimit të shërbimeve në raste të jashtëzakonshme emergjencash në kundërshtim me pikën 1 shkronja c) dhe ç), të VKM nr. 710, datë 21.08.2013, i ndryshuar.

-Për procedurat e back up, UV nuk ka të dokumentuar ndonjë dokument administrativ si Rregullore e Brendshme apo dokument tjetër TIK ku të përcaktohet mënyra e kryerjes së backup-ve.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 28-36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

8.1.Rekomandimi: Strukturat drejtuese në Universitetin e Vlorës në bashkëpunim me sektorin e IT-së të marrin masa për ndërtimin dhe hartimin e planeve të vazhdimësisë së biznesit duke përfshirë planet për backup për sistemet, pajisjet kompjuterike dhe të dhënat, me qëllim garantimin e sigurtisë së informacionit dhe uljen e riskut për ndërprerjen e shërbimeve dhe vazhdimësisë së punës.

Në vijimësi

9.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në hyrjen kryesore të Rektoratit të UV është instaluar një sistem i veçantë aksesit për hyrje daljet e punonjësve të UV por ky sistem nuk është funksional dhe nuk përdoret për të monitoruar hyrje – daljet, duke kompromentuar nivelin e sigurtisë së aksesit në ambientet e saj me qëllim kufizimin e aksesit fizik të personave të paautorizuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 28-36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

9.1.Rekomandimi: Strukturat drejtuese në Universitetin e Vlorës në bashkëpunim me sektorin e IT-së të marrin masa për të analizuar nivelin e sigurtisë së aksesit në ambientet e rektoratit me qëllim kufizimin e aksesit të personave të paautorizuar që nuk janë pjesë e administratës por edhe për të administruar hyrje daljet e stafit të administratës së rektoratit si dhe të marri masa për vendosjen në funksion të sistemit të aksesit që ka të instaluar në godinën e rektoratit.

Në vijimësi

10.Gjetje nga auditimi: Për periudhën e audituar, u konstatua se Universiteti i Vlorës nuk ka politika të ruajtjes së dokumenteve dhe nuk ka të dokumentuar një plan masash për identifikimin, trajtimin e gabimeve dhe incidenteve që mund të ndodhin në infrastrukturën IT, dhe në mungesë të procedurave të shkruara, risqet menaxhohen mbi bazë ngjarjesh. Suporti, mbështetje teknike dhe logjike për operacionet IT që ndihmojnë mbarëvajtjen e strukturave të institucionit, kryhen nëpërmjet shkëmbimeve verbale dhe nëpërmjet e-mail-eve.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 28-36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

10.1.Rekomandimi: Strukturat Drejtuese në Universitetin e Vlorës në bashkëpunim me sektorin TIK të marrin masa për identifikimin, dokumentimin dhe monitorimin e incidenteve si dhe menaxhimin e ndryshimeve dhe dokumentimin e tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

11.Gjetje nga auditimi:

-Nga auditimi u konstatua se ambienti fizik i dhomës së serverëve ku është hostuar sistemi i bibliotekës dixhitale në Universitetin e Vlorës nuk është në përputhje me standardet e përcaktuara në rregulloren për ndërtimin e dhomës së serverëve të miratuar nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit.

-Shërbimet që ofron teknologjia e informacionit në UV mbështeten në një infrastrukturë IT jo të konsoliduar dhe në disa pjesë është e amortizuar. Shërbimet e ngritura mbi këtë rrjet nuk janë të sigurt dhe nuk mbështesin vazhdimësinë e punës dhe perspektiven e zhvillimeve të përcaktuara.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 28-36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

11.1.Rekomandimi: Strukturat drejtuese në Universitetin e Vlorës në bashkëpunim me sektorin e IT-së të marrin masa për planifikimin dhe ngritjen e një infrastrukturë IT

(ambienteve të dhomës të serverëve dhe rrjetin network) në përputhje me kushtet teknike të përcaktuara në rregulloren e miratuar nga AKSHI, që parashikon përcaktimin e standardeve të TIK si dhe në përputhje me udhëzimet, standardet dhe praktikat më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare.

Në vijimësi

12.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Universiteti i Vlorës, nuk ka vënë në përdorim sistemin Pitagora ofruar nga RASH, megjithëse vet ky universitet ka nënshkruar dhe është bërë pjesë e marrëveshjes së bashkëpunimit me Rrjetin Akademik Shqiptar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 37-43 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

12.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese në Universitetin e Vlorës në bashkëpunim me sektorin e IT-së, të marri masa për të analizuar,identifikuar dhe dokumentuar të gjitha arsyet teknike, financiare dhe ligjore për të cilat nuk kanë vënë në përdorin sistemin Pitagora ofruar nga Rrjeti Akademik Shqiptar, si një detyrim që rrjedh nga marrëveshja e nënshkruar ndërmjet universiteteve dhe RASH.

Menjëherë

12.2 Rekomandimi: Universiteti i Vlorës të adresojë në institucionet përgjegjëse që janë Ministria e Arsimit dhe RASH, çështjet që e kanë penguar të vërë në funksion sistemin Pitagora, në mënyrë që të nxiten të gjithë faktorët për qartësimin dhe saktësimin njëherë e mirë mbi të drejtën e zhvillimi të sistemeve informatike që ndërtohen në shërbim të studentëve në mënyrë që të parandalohen investime me qëllime të njëjta.

Menjëherë

13.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi dokumentacionin e hartuar mbi sistemin UVMS, u konstatua se:

- Mungon një akt rregullatorë të brendshëm për menaxhimin e log-eve të përdoruesve.
- Nuk ka manual administrimi të sistemit UVMS.
- Nuk janë ndërtuar në mënyrë skematike Workflow për proceset e punës që ndjekin në sistem stafi akademik, administrativ si dhe studentët.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 37-43 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

13.1 Rekomandimi: Universiteti i Vlorës, të marrë masa për hartimin dhe miratimin e dokumentacionit që mungon si workflow, manuali i administrimit si dhe mënyra se si do të administrohen log-et e përdoruesve, si dokumentacion i nevojshëm për gjurmën e auditimit në sistemin UVMS.

Menjëherë

14.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi të dhënat e regjistruara në arkivën dixhitale, u konstatua se:

- Dixhitalizimi i arkivës është i ngadaltë dhe do të vazhdojë po në të njëjtën situatë nisur nga fakti se në këtë proces janë angazhuar vetëm dy punonjësit e bibliotekës.
- Ky sistem nuk aksesohet ende nga studentët pasi është në fazën e popullimit të të dhënave dixhitale. Aktualisht në këtë sistem punojnë vetëm dy punonjësit e bibliotekës të cilët janë dhe punonjësit e ngarkuar për dixhitalizimin.
- Me hapat që po ecën procesi i popullimit në bibliotekën dixhitale, nuk do të jetë gati për shumë vjet, çfarë sjell jo vetëm një amortizim të pajisjeve, por një risk shumë i lartë se materialet e skanuara pas shumë vitesh nuk do t'i shërbejnë më studimeve universitare. Qëllimi i këtij investimi kundrejt studentëve dhe stafit akademik të universitetit mund të mos arrihet.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 37-43 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

14.1 Rekomandimi: Universiteti i Vlorës, të marrë masa për përcaktimin e afatit maksimal të dixhitalizimit të materialeve aktuale që ndodhen në bibliotekën e universitetit dhe që i shërbejnë programeve studimore universitare.

Menjëherë

14.2 Rekomandimi Universiteti i Vlorës, të marrë masa për sigurimin e burimeve njerëzore të përkohshme, të nevojshme për të përmbushur afatin maksimal të dixhitalizimit të bibliotekës së këtij universiteti, çfarë do të garantojë vënien në punë në një kohë të shpejtë dhe përmbushjen e qëllimit të këtij investimi informatik, duke ju ofruar studentëve materialet e nevojshme për çdo program studimi në kohë reale.

Në vazhdimësi

15.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi të dhënat e përdoruesve të hapur në sistemin UVMS u konstatua se, UV për periudhën nën auditim nuk disponon një akt rregullativ, për administrimin e përdoruesve në të cilin të përcaktohen procedurat që do të ndiqen për krijimin, ndryshimin dhe mbylljen e tyre.

Nga verifikimi në nivel administrativ që grupi i auditimit kreu në sistem lidhur me krijimin, ndryshimin dhe mbylljen e përdoruesit, rezultoi se nuk është ndjekur i njëjti standard në krijimin e përdoruesit:

- Në një rast është krijuar sipas modelit emërmbiemër;
- Në disa raste janë krijuar sipas modelit emër.mbiemër;
- Në disa raste sipas modelit emër.

Ka përdorues me kredenciale të përgjithshme:

- 4 përdorues me emër zyra4, zyra1, zyra2, zyra3
- 15 përdorues me emër menaxhofshp, depinfermieri, depekonomiks, depfinance, menaxhofsht, menaxhofe, menaxhofi, menaxhofshh, depbiznesi, menaxhoft etj.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 37-43 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

15.1 Rekomandimi: Universiteti i Vlorës të marrë masa për të identifikuar dhe miratuar një standard dhe akt rregullativë mbi menaxhimin e përdoruesve si një mjet i domosdoshëm i cili garanton gjurmën e veprimeve të përdoruesve dhe ofron një identifikim më të sigurt në sistemet informatike.

Menjëherë

15.2 Rekomandimi: Sektori i IT në Universitetin e Vlorës të marrë masa që në bazë të rregullores së miratuar për përdoruesit dhe standardit të aprovuar për identifikimin e përdoruesit, të bëjë korrigjimet e nevojshme në emërtimin me saktësi të përdoruesit kur këto emërtime janë vendosur me shkurtime, emra departamentesh apo emra zyre.

Në vazhdimësi

B. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

1.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se investimi në vlerën 24,499,000 lekë pa TVSH me urdhër nr.957/1 datë 22.06.2020 të administratorit për procedurën e prokurimit: ‘Krijimi i Datacenter dhe Ndërtimi i Sistemit të Integruar për menaxhimin e bibliotekës dixhitale’ është një investim pa efektivitet. Qëllimi për realizimin e këtij investimi është i njëjtë me investimin e planifikuar nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, si një nga premtimet e “Paktit për Universitetin” që do të adresonte problematikën e kostove të blerjes së librave dhe do të rriste aksesin e studentëve në botime të

ndryshme Universitare. Ndërtimi i një biblioteke online me standarde evropiane ishte një ndër kërkesat e studentëve. Përfitues i këtij investimi është dhe universiteti “Ismail Qemali”
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqe 14-28 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1.Rekomandimi: Strukturat drejtuese në Universitetin e Vlorës të marrin masa duke analizuar mangësitë e konstatuara dhe në të ardhmen të miratojnë realizimin e procedurave të prokurimit të cilat sjellin përmirësim dhe ndihmojnë në përmbushjen e misionit të Universitetit, për stafin akademik dhe studentët.

Menjëherë

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT